

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5856
E martë, 20 gusht 2019
çmimi 0.40 €

A është e përgatitur Kosova për ndryshimin e qeverisë? | FAQE 8

Shkruan:
Bedri Islami



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PARTITË POLITIKE KANË NISUR PËR PJEKJET PËR KOALICIONE PARAZGJEDHORE

Zyrtarizohet koalicioni i parë parazgjedhor

FAQE 4-5



Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partia Socialdemokrate (PSD) kanë bërë koalicion parazgjedhor. Liderët e këtyre dy subjekteve politike të hënën kanë zyrtarizuar bashkëpunimin parazgjedhor duke

arritur kështu koalicionin e parë për zgjedhjet e parakohshme. Në bazë të kësaj marrëveshje, partitë do të garojnë në një listë zgjedhore. Kandidati për kryeministër do të jetë nga radhët e AAK-së, ndërsa numër dy në listën e

këtij koalicioni do të jetë Shpend Ahmeti. Ramush Haradinaj dhe Shpend Ahmeti janë shprehur të bindur se ky do të jetë koalicioni i fitores dhe i shpresës për qytetarët e Kosovës

Mungesa e reformës mund t'u hapë rrugë manipulimeve në zgjedhje

Analistët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë vlerësuar se partitë politike qëllimisht nuk po e përfundojnë procesin e reformës zgjedhore. Analisti politik Imer Mushkolaj dhe Artan Murati nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) kanë



thënë për gazetën "Epoka e re" se shkuarja në zgjedhje të reja pa reformë do të sjellë mangësi. Sipas tyre, mungesa e reformës mund t'u hapë rrugë manipulimeve në zgjedhjet e parakohshme që pritet të mbahen në vjeshtë | FAQE 3

Veseli thotë se ministri Uran Ismaili ka bërë ndryshime në shëndetësi

FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Çurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

AKTUALE

ANULOHEK KONKURSI PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË KIOSKAVE NË PRISHTINË | F. 6

NISMËS SOCIALDEMOKRATE I BASHKOHET BEKIM BRESTOVCI | F. 5

FSK-ja, PJESË E USHTRIMIT SHUMËKOMBËSH NË GJERMANI | F. 7



EKONOMI

NISIN TAKIMET PËR PRIVATIZIMIN E TELEKOMIT | F. 9

VAZHDON GREVA NË ANP 'ADEM JASHARI' | F. 8

KULTURË

MINISTRI GASHI FALËNDERON O'CONNELLIN PËR PËRKRAHJE NË TRASHËGIMINË KULTURORE | F. 7

SPORT

BEQIRI: FITORJA NDAJ GJILANIT, MOTIV PËR NDESHJET E TJERA | F. 13

Vuçiqi në Uashington, takon sekretarin Pompeo

BEOGRAD, 19 GUSHT - Sot (e martë), presidenti serb Aleksandar Vuçiq, do të takohet me sekretarin amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, në marginat e një takimi të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, thuhet në një deklaratë të Departamentit të Shtetit. Radio Televizionit i Serbisë, raportoi se tema kryesore e bisedimeve midis Vuçiqit dhe

Pompeos, do të jetë situata në Kosovë. Pompeo do të marrë pjesë në një seancë të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Lindjen e Mesme, dhe është planifikuar të takohet edhe me sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres. Shtetet e Bashkuara kanë bërë thirrje për arrijtjen sa më parë të një marrëveshjeje midis Kosovës

dhe Serbisë. Mirëpo, bisedimet e lehtësuara nga Bashkimi Evropian janë ndërprerë që nga nëntori i vitit të kaluar, për shkak të tarifës ndaj mallrave serbe të cilën e ka vendosur Qeveria e Kosovës. Masa, sipas zyrtarëve në Prishtinë, është marrë për shkak të fushatës kundër shtetësisë së Kosovës, që e kanë zhvilluar zyrtarët serbë.



Konstituohet Këshilli i ri bashkiak i Shkodrës, opozita proteston

Derisa përkrasës të opozitës u përplasën me kordonët e policisë, teksa përpiqeshin të hynin në ndërtesë dhe të ndalnin ceremoninë konstituive të ndjekur nga këshilltarët e rinj, Këshilli i ri bashkiak i Shkodrës, i dalë nga zgjedhjet vendore të 30 qershorit, të hënën mbajti seancën konstituive dhe për drejtuese u zgjodh Briseida Kadia



SHKODËR, 19 GUSHT - Këshilli i ri bashkiak i Shkodrës, i dalë nga zgjedhjet vendore të 30 qershorit, u konstituua të hënën në mjediset e Universitetit "Luigj Gurakuqi", ndërsa përkrasës të opozitës protestonin jashtë. Situata u tensionua kur banorët dhe protestuesit u përplasën me kordonët e policisë, teksa përpiqeshin të hynin në ndërtesë dhe të ndalnin ceremoninë konstituive të ndjekur nga këshilltarët e rinj. Sipas opozitës, konstituimi i këtij këshilli është i jashtëligjshëm dhe nuk përfaqëson qytetarët e Shkodrës. Këshilli bashkiak i Shkodrës zgjodhi si drejtuese Briseida Kadia. Protestuesit ndoqën këshilltarët bashkiakë dhe politikanët socialistë të ardhur nga kryeqyteti sapo dolën nga ceremo-

nia me thirrjet "Turp! Turp!". Policia disa herë u përpoq ta ndalonte këtë marshim spontan dhe kjo krijoi përplasje të saja me protestuesit. Kryetari i Partisë Demokratike të opozitës, Lulzim Basha, deklaroi përmes Facebook-ut se "beteja e sotme në Shkodër është beteja e çdo shqiptari që nuk pranon dhunën, hajdutërinë dhe kriminelët e Edi Ramës, nuk pranon papunësinë, padrejtësinë dhe arrogancën e tij". Sipas tij, qëllimi i opozitës është të nxjerrë këta njerëz nga institucionet qendrore, nga Parlamenti e deri te bashkitë, sepse ata i pushtuan ato me dhunë e paligjshmëri. "T'u vëmë prangat dhe t'i pastrojmë institucionet dhe rrugët e Shqipërisë, të pastrojmë ekonominë shqiptare nga këta

banditë dhe hajdutë dhe t'ua kthejmë Shqipërinë njerëzve", tha Basha, ka njoftuar voa. Ndërsa për kryetarin e grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, sot shkodranët kanë "kuvendin" e tyre të ri vendor, të përbërë nga 51 këshilltarë bashkiakë të zgjedhur në zgjedhjet vendore të 30 qershorit.

"Partia Socialiste i shpreh ndjesë komunitetit të nderuar të Bashkisë së Shkodrës për situatën e krijuar pas dorëheqjes së detyrueshme të kryetarit të zgjedhur të Bashkisë, por si në çdo rast, ne qëndruam përtej çdo interesi partiak, politik apo individual, vetëm në anën e ligjit dhe të interesit publik", tha Balla në Facebook, duke thek-

suar se ligji është i barabartë për të gjithë dhe ai vetëm duhet zbatuar nga kushdo. Kryetari i zgjedhur bashkiak në zgjedhjet e 30 qershorit, Valdrin Pjetri, u tërhoq nga ky post, pas publikimit nga opozita të dokumenteve italiane, të cilat provonin se ai u dëbua në vitin 2003 pas dënimit gjyqësor, si i përfshirë në trafik droge.

Brexit-i pa marrëveshje i jep fund lëvizjes së lirë

LONDËR, 19 GUSHT - Kryeministri britanik, Boris Johnson ka thënë se rregullat për shtetasit e ndonjë vendi të Bashkimit Evropian për të jetuar dhe punuar në Britani do të përfundojnë në fund të muajit tetor, nëse Britania largohet nga blloku evropian pa marrëveshje. Qeveria e ish-kryeministres Theresa May kishte shqyrtuar mundësinë e lëvizjes së lirë deri më 2021, duke përmendur mundësinë e lejimit të qytetarëve evropianë që të qëndrojnë në Britani për tre muaj, para se të aplikojnë për të qëndruar më

gjatë. Megjithatë, të dyja mundësitë tani janë hedhur poshtë, në këmbim të një qasjeje të re, që pritet të publikohet më vonë. Konsiderohet se në Britani jetojnë 3 milionë banorë të bllokut evropian. Bazuar në lëvizje të lirë, aktualisht qytetarët e BE-së mund të jetojnë dhe punojnë në vende tjera të këtij blloku. Mirëpo kur është pyetur për këtë çështje, Johnson ka thënë se Britania "nuk do të jetë armiqësore ndaj imigrimit apo imigrantëve".


Sipas tij "imigrimi në Britani do të kontrollohet në mënyrë demokratike". Në rast të Brexit-it pa marrëveshje, qytetarët britanikë që kanë leje të përhershme të qëndrimit në Britani, e cila fitohet pas pesë vjetëve jetesë aty, nuk do të rrezikohen. Kryeministri i ri britanik, Boris Johnson ka thënë se do ta largojë Britaninë në këtë datë me apo pa marrëveshje nga blloku evropian, derisa ligjvënësit britanikë janë zotuar se do të rrezikojnë secilën qeveri që tenton të largojë Britaninë nga blloku evropian pa



një marrëveshje. Vendimi për largim të Britanisë nga blloku evropian ka ardhur pasi 52 për qind e votuesve kanë

votuar për dalje të Britanisë nga BE-ja kundruall 48 për qind që kanë kundërshtuar atë, në referendumin e mbajtur më 2016.

Mungesa e reformës mund t'u hapë rrugë manipulimeve në zgjedhje



Analistët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë vlerësuar se partitë politike qëllimisht nuk po e përfundojnë procesin e reformës zgjedhore. Analisti politik Imer Mushkolaj dhe Artan Murati nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se shkuarja në zgjedhje të reja pa reformë do të sjellë mangësi. Sipas tyre, mungesa e reformës mund t'u hapë rrugë manipulimeve në zgjedhjet e parakohshme që pritet të mbahen në vjeshtë

mund t'u hapë rrugë edhe manipulimeve të ndryshme në zgjedhje, por njëkohësisht edhe zvarritjeve të krijimit të koalicioneve qeveritare", ka deklaruar Mushkolaj. Pavarësisht prej krijimit të koalicioneve parazgjedhore, ai ka thënë se mungesa e reformës mund të prodhojë edhe kriza politike pas zgjedhjeve. "Kësaj radhe gjërat do të jenë pak më të qarta në kuptimin se, megjithatë, po portretizohen diku katër grupe politike. Edhe logjika është që dy grupe ta krijojnë koalicionin dhe dy të tjera të mbesin në opozitë. Megjithatë, kjo nuk është fare garancie se prapë nuk do të ketë probleme pas zgjedhjeve, sidomos nëse hyn në lojë presioni ndërkombëtar për përfshirjen ose jo të ndonjë partie të caktuar në koalicion për 'interesa madhore të Kosovës' qysh zakonisht ndodhë", është shprehur Mushkolaj, duke shtuar se nuk ishte dashur të ketë zvarritje sikur herëve të kaluara për shkak se Gjykata Kushtetuese me kohë e ka bërë me dije mënyrën e krijimit të institucioneve. "Në anën tjetër, koalicionet e hershme në një farë forme po ma krijojnë përshtypjen se mund të ketë më shumë qartësi duke i ravizuar katër grupe politike kryesore

që pastaj edhe gara që e bëjnë të jetë më e qartë dhe kjo nënkupton se edhe rezultati final do të jetë më i qartë", ka theksuar ai. Edhe Artan Murati nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka thënë për gazetën "Epoka e re" se nuk ka vullnet politik për të përfunduar reforma zgjedhore. "Ndonëse qysh në vitin 2011 ka pasur tendenca të fillojë një reformë zgjedhore, ende nuk ka asgjë konkrete meqenëse nuk ka vullnet të subjekteve politike për mënyrën se si të bëhet kjo reformë. Sidomos çështja e zonave zgjedhore dhe çështjet e tjera ende nuk kanë arritur të adresohen dhe trajtohen nga subjektet politike. Në anën tjetër, në mënyrë që të lehtësohet edhe mënyra se si bëhen koalicionet dhe ndarja e pozitave më pas, jodomosdoshmërisht duhet të kryhet reforma zgjedhore. Një pikënisje e mirë do të ishte edhe Ligji për Qeverinë i cili do ta specifikonte madhësinë e qeverisë dhe në këtë mënyrë edhe subjektet politike do ta dinin qysh në fillim se sa poste mund t'i ndajnë", ka deklaruar Murati, duke shtuar se edhe me Ligjin për financimin e subjekteve politike do të mund të rregulloheshin disa çështje të cilat kryesisht do të kishin të bënin me transparencën e

financave politike, mënyrën e shpenzimeve, fushatën politike dhe pastaj me një reformë të mirëfilltë për zonat zgjedhore, pastrimin e listave të votueseve e kështu me radhë. Ai ka thënë se shkuarja në zgjedhje pa reformë zgjedhore pa dyshim se i ka mangësitë e veta. "Manipulimet në zgjedhje ndërliken edhe me këto ligjet që i përmenda, sidomos me Ligjin për financimin e subjekteve politike. Shkuarja në zgjedhje pa reformë zgjedhore pa dyshim se i ka mangësitë e veta të cilat do të evitoheshin në masë të madhe nëse do të përfundohej reforma", ka theksuar Murati. Sipas tij, kriza politike është duke ndodhur për shkak kryesisht të disa aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese. "Ato janë norma kushtetuese dhe faktikisht janë edhe më problematike edhe të trajtohen. Këto janë çështje të cilat nuk mund të zgjidhen vetëm me ligje të caktuara, por duhet të ketë rishikim të mirëfilltë të dispozitave kushtetuese, të rregullores së punës së Kuvendit në mënyrë që të garantohet se nuk do të ketë kriza dhe as nuk do të ketë kalkulime të mëdha politike që do ta dëmtonin edhe krijimin e institucioneve të reja dhe do ta prolongonin këtë proces edhe më tepër", ka thënë Murati.

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 19 GUSHT - Pavarësisht prej përpjekjeve disavjeçare, ende nuk është arritur të përfundohet procesi i reformës zgjedhore. Prandaj edhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare do të mbahen sipas legjislacionit aktual. Për mangësitë që do t'i sjellë mungesa e reformës zgjedhore, të hënën kanë folur analistët politikë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile. Analisti politik Imer Mushkolaj ka thënë për gazetën "Epoka e re" se qëllimisht reforma është bllokuar tash e sa vite nga subjektet politike. Ai ka thënë se

mungesa e kësaj reforme mund t'u hapë rrugë manipulimeve në procesin zgjedhor. "Po të ishin të interesuara partitë politike atëherë reforma do të ishte kryer, mirëpo po duket se mungon vullneti politik dhe për këtë shkak qytetarët janë duke e vuajtur mungesën e reformës zgjedhore sepse vota e tyre në shumë raste nuk është se shkon në vendin e duhur, në kuptimin se nuk mund të sigurohet se ajo do të vlerësohet ashtu si duhet vlerësuar. Reforma zgjedhore është bllokuar nga partitë politike dhe kjo përkthehet në atë se ata janë të interesuar të vazhdojnë me të njëjtën logjikë që

Partitë politike kanë nisur përpjekjet për koalicione parazgjedhore

Zyrtarizohet koalicioni



Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partia Socialdemokrate (PSD) kanë bërë koalicion parazgjedhor. Liderët e këtyre dy subjekteve politike të hënën kanë zyrtarizuar bashkëpunimin parazgjedhor duke arritur kështu koalicionin e parë për zgjedhjet e parakohshme. Në bazë të kësaj marrëveshje, partitë do të garojnë në një listë zgjedhore. Kandidati për kryeministër do të jetë nga radhët e AAK-së, ndërsa numër dy në listën e këtij koalicioni do të jetë Shpend Ahmeti. Ramush Haradinaj dhe Shpend Ahmeti janë shprehur të bindur se ky do të jetë koalicioni i fitores dhe i shpresës për qytetarët e Kosovës

Ahmeti. Në fitoren e këtij koalicioni është shprehur i bindur edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj. Ai ka thënë se ky është një koalicion i shpresës për qytetarët e Kosovës. "Ne nuk po presim prej askujt. Ne po krijojmë boshtin e fitores për këto zgjedhje, po krijojmë konceptin e fitores që mendoj se është shpresë për qytetarët e vendit", ka thënë Haradinaj. Lideri i AAK-së ka bërë me dije se ky koalicion parazgjedhor është mbështetur nga organet më të larta të dy subjekteve politike, duke mos pasur asnjë kundërshtim. "Sot është përmbyllja e një pune të përbashkët, jo të lehtë. Kjo punë ka pasur për bazë qëllimet programore të PSD-së dhe AAK-së dhe kemi arritur t'i bashkojmë ekspertizat më të mira që kemi në parti. Mund t'ju them

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 19 GUSHT - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partia Socialdemokrate (PSD) të hënën kanë zyrtarizuar koalicionin e parë parazgjedhor. Bartës i listës së këtij koalicioni dhe kandidat për kryeministër do të jetë Ramush Haradinaj, ndërsa numër dy i listës do të jetë Shpend Ahmeti. Pas nënshkrimit

të kësaj marrëveshje, liderët e këtyre subjekteve politike kanë treguar se të dy partitë do të garojnë në një listë zgjedhore, derisa kandidati për kryeministër do të jetë nga radhët e AAK-së. Në konferencën për media, Shpend Ahmeti dhe Ramush Haradinaj janë shprehur të bindur se kanë formuar boshtin e fitores për zgjedhjet e reja. "Pas negociatave që kemi pasur ndërmjet dy subjekteve tona, kemi

arritur marrëveshje që në zgjedhjet të ardhshme PSD-ja dhe AAK-ja do të garojnë bashkë. Ky është një bashkëpunim edhe politik edhe zgjedhor, duke marrë parasysh disa vija të bashkëpunimit që i kemi pasur edhe në vitet e kaluara, por që janë zgjeruar në fusha të tjera, me të cilat në do të garojmë bashkë me një program të përbashkët qeverisës", ka thënë Ahmeti. I pari i PSD-së është shprehur i

bindur se ky koalicion është pretendenti kryesor për t'i fituar zgjedhjet e reja. "Ne sot e kemi ndërtuar boshtin e këtij koalicioni fitues. Ne me gatishmëri të plotë e presim shpërndarjen e Kuvendit të enjten që t'u hapim rrugë zgjedhjeve, që pastaj më 29 shtator apo më 6 tetor të jemi të gatshëm. Ashtu siç po tregojnë sondazhet, ky koalicion parazgjedhor është pretendenti serioz për t'i fituar këto zgjedhje", ka deklaruar

ni i parë parazgjedhor



se sot në AAK u votua ky koalicion parazgjedhor. Mendoj se sot jemi më të përgatitur për të marrë përgjegjësi për këto zgjedhje, për ato tema që shqetësojnë jetën tonë", është shprehur Haradinaj.

Koalicioni AAK-PSD, i hapur edhe për parti të tjera

Ramush Haradinaj dhe Shpend Ahmeti janë shprehur të hapur edhe për bashkëpunime të tjera parazgjedhore. Sipas tyre, Nisma dhe AKR-ja do të ishin aleatë më të natyrshëm për ta. "Jemi të hapur për bashkëpunim me Nismën, AKR-në, pra me këto parti që kemi edhe një komunikim të ndërsjellë. Nuk synojmë PAN 2 apo PAN 3. Nuk jemi pjesë e skenarëve për një PAN të ri dhe këtë e themi me përgjegjësi të

plotë", ka thënë Ramush Haradinaj.

Kurse Shpend Ahmeti ka thënë se kandidat për kryeministër i këtij koalicioni do të jetë lideri i AAK-së. "Jemi marrë vesh të garojmë me një listë dhe bartës i kësaj liste do të jetë kandidati i AAK-së, në këtë rast z. Haradinaj. Me këtë ne nuk e mbyllim procesin e koalicioneve parazgjedhore. Tashmë së bashku PSD-ja dhe AAK-ja do të kontaktojnë edhe me subjekte të tjera në mënyrë që ta zgjerojnë koalicionin fitues", ka theksuar ai.

Ahmeti ka përmendur disa prej kërkesave të programit të përbashkët. "Në këtë betejë sot po i bashkojmë forcat si PSD me AAK-në. Synim kryesor kemi t'i fitojmë zgjedhjet me një program të përbashkët qeverisës. Në këtë program i kemi vendosur disa

kërkesa të cilat kanë qenë të drejtuara, duke marrë parasysh qëndrimet e ndryshme. Po ashtu, kemi kërkuar edhe për qëndrimet që i kemi të njëjta, që ta shtojmë programin që mendojmë se është i domosdoshëm", ka thënë Ahmeti, duke shtuar se prioritet do të vazhdojë të jetë paga minimale, të drejtat e punëtorëve, zhvillimi ekonomik dhe lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Para se liderët e këtyre dy partive ta firmosin koalicionin parazgjedhor, pro këtij koalicioni ka votuar edhe Këshilli Drejtues i AAK-së dhe ai i PSD-së, si organet më të larta partiake.

Edhe LDK-ja në kërkim të aleatëve

Lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka nisur përpjekjet për t'i siguruar aleatët parazgjedhorë. Të hënën ai ka takuar kryetarin e PSD-së, Shpend Ahmeti, më pas liderin e Nismës, Fatmir Limaj. Ky i fundit pas takimit ka thënë se Kosovës i duhet një qeveri që kryen punë. "Kosovën e presin tema të rëndësishme. Duhet të jemi të kujdesshëm në fazën e parë zgjedhore. Kosovës i duhet një qeverisës e cila kryen punë. Është një moment i rëndësishëm dhe vendi mjaft ka humbur. Është momenti që vetë procesi zgjedhor ta karakterizojë seriozitetin për qeverinë e

Vetëvendosje reagon ndaj koalicionit të PSD-së me AAK-në

Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albulena Haxhiu, ka thënë se arritja e koalicionit AAK-PSD konfirmon konstatimin se PSD-ja ka qenë vazhdimisht në pushtet. Ajo ka thënë se PSD-ja ka demaskuar veten duke pranuar poshtërimin publik, vetëm për ta shmangur vendimin eventual për mosshkuarje në zgjedhje. "Koalicioni mes AAK-së dhe këtyre të Shpendit më në fund i zhveshi komplet. Ky koalicion konfirmon konstatimin e ripërsëritur disa herë nga Lëvizja Vetëvendosje se ata kanë qenë vazhdimisht në pushtet. Ata i kanë dhënë mbështetje PAN-it sa herë që i janë ligështuar këmbët. Edhe tash zyrtarizoi koalicionin me kryeministrin e

PAN-it", ka shkruar ajo në profilin e vet në "Facebook".

Haxhiu ka deklaruar se ndodhi ajo që ka paralajmëruar LV-ja, se PSD-ja nuk guxon të shkojë e vetme në zgjedhje. "Klika që doli nga Vetëvendosja, me 12 ulëset në Kuvend, për të cilët vazhdimisht ka insistuar se janë të fituara e jo të vjedhura, hyri në negociata për koalicion parazgjedhor me një subjekt tjetër politik (AAK) që, po ashtu, ka 12 ulëse. Sikur ata vetë, ose edhe AAK-ja vetëm pak të kishin besuar se këto ulëse janë të fituara e jo të vjedhura, diskutimi do të shkonte drejt ndarjes së barabartë të numrit të kandidatëve në listën e përbashkët zgjedhore", ka shkruar deputetja Haxhiu.

ardhshme. Nuk është mirë që fushatat të bëhen me patriotizëm e pastaj të veprohet krejt ndryshe", ka thënë Limaj, duke shtuar se me liderin e LDK-së ka biseduar për të gjitha temat. Kryesia e Kuvendit ka vendosur që seanca për shpërndarjen e legjislaturës së VI të mbahet këtë të enjte. Deri më tani të gjitha subjekte politike parlamentare

kanë shprehur vullnetin e tyre që të votojnë pro shpërndarjes së Kuvendit, në mënyrë që vendi të shkojë në zgjedhje të reja. Sipas kushtetutës, pas shpërbërjes së Kuvendit brenda 45 ditëve duhet të organizohen zgjedhjet e reja. Nëse Kuvendi shpërndahet më 22 gusht, si data më të përafërta për zgjedhje janë përmendur 29 shtatori dhe 6 tetori.

Nismës Socialdemokrate i bashkohet Bekim Brestovci

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 GUSHT - Nismës Socialdemokrate të hënën i është bashkuar afaristi i njohur nga diaspora, Bekim Brestovci. Në një konferencë për medie, në të cilën është bërë publik aderimi i Brestovcit, lideri i Nismës, Fatmir Limaj, ka thënë se ky subjekt politik ndihet i nderuar që po i bashkohet një personalitet i rëndësishëm. "Angazhimi i tij për Kosovën nuk është ndalur asnjëherë, por ka ndryshuar forma varësisht nga nevojat që ka pasur vendi. Ne si Nismë jemi të nderuar për ardhjen e një personaliteti të jashtëzakonshëm", ka thënë Limaj.

Më tutje, kreu i Nismës ka thënë se shembulli i Brestovcit duhet të shërbejë për t'i inkurajuar njerëzit tanë në mërgatë që të kthehen dhe të kontribuojnë për vendin, sepse Kosova ka nevojë



për njerëz të tillë. "Bekim Brestovci ka pasur një milion alternativa më të mira, por ka zgjedhur që përmes Nismës Socialdemokrate t'i kontribuojë vendit dhe ky është lajm i jashtëzakonshëm për Kosovën, sepse po kthehet për ta fuqizuar zërin e mërgatës. Pra, bëhet fjalë për një personalitet i cili i ka mbi 1 200 punëtorë në Gjermani, i cili i ka lënë të gjitha atje dhe ka ardhur t'i shërbejë vendit", ka shtuar Limaj.

Ndërsa Bekim Brestovci ka thënë

se nga sot po nis një rrugë të re, duke shtuar se për vite ka jetuar në Gjermani, por asnjëherë nuk ka hequr dorë nga kontributi për popullin e Kosovës dhe komunitetin shqiptar në mërgatë. "Sado që bëhet për atdheun, nuk është asnjëherë mjaft. Aktiviteti im në unionin e biznesit shqiptarogjerman ka qenë dhe do të mbetet një nga veprat që do të krenohem gjithëherë. Vendi tani ka nevojë për zhvillim ekonomik dhe ky do të jetë i gjithë përkushtimi im", ka theksuar Brestovci.

Anulohet konkursi për dhënie në shfrytëzim të kioskave në Prishtinë

PRISHTINË, 19 GUSHT (ER) - Pas akuzave dhe kundërakuzave, se vendimi për hapjen e konkursit ka qenë për interesa personale,

Kuvendi Komunal i Prishtinës me 28 vota për dhe 11 kundër ka anuluar konkursin për dhënie në shfrytëzim të

kioskave. Përfaqësuesit dhe pronarët e kioskave para fillimit të seancës kanë protestuar para komunës, pastaj ata me

fillimin e seancës kanë hyrë në sallën e Kuvendit Komunal, ku pas një diskutimi mbi një orë ky vendim është shfuqizuar.



Meremetimi i shkollave në Komunën e Malishevës, në përfundim e sipër

MALISHEVË, 19 GUSHT (ER) - Në kuadër të përgatitjeve të Drejtorisë Komunale për Arsimit në Komunën e Malishevës, për fillimin e vitit të ri shkollor 2019-2020 është duke u bërë edhe meremetimi i objekteve shkollore, në ato objekte të cilat kanë nevojë për meremetim. Punimet për meremetimin e shkollave i kanë inspektuar nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha dhe drejtori i Arsimit, Blerim Thaçi. Berisha dhe Thaçi janë ndarë të

kënaqur me punimet e kryera deri më tani dhe kanë marrë zotimin nga operatori, se të dhjetë objektet shkollore, përfshirë edhe çerdhen, do të jenë të gatshme për fillimin e vitit të ri shkollor.

Meremetimet në objektet shkollore janë në përfundim e sipër. Nënkryetari Berisha dhe drejtori Thaçi janë takuar edhe me disa nga drejtorët e shkollave me të cilët kanë biseduar për përgatitjet për fillimin sa më të mirë të vitit të ri shkollor.



Mungesa e printerëve u sjell vështirësi drejtorive komunale në Mitrovicë

MITROVICË, 19 GUSHT (ER) - Drejtuar nga kryetari i komunës, Agim Bahtiri, dhe në prani të nënkryetarit, Faruk Mujka, të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve, në të cilën janë diskutuar disa pika të rendit të ditës që janë me interes për qytetarët e Komunës së Mitrovicës. Fillimisht zyrtari kryesor financiar, Adem Fazliu, ka prezantuar qarkoren e brendshme buxhetore për vitin 2020/02, duke theksuar se qëllimi i saj është që drejtorët e drejtorive, zyrat dhe përgjegjësitë e programeve buxhetore të njoftohen me informatat që kërkohen për fillimin e procesit të planifikimit të projektbuxhetit për vitin 2020

dhe parashikimet për 2021-2022. Ai ka thënë se përgjegjësitë dhe autorizuesit për planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit, sipas programeve buxhetore dhe kategorive ekonomike të shpenzimeve, janë bazuar në qarkoren buxhetore 2020/02 për komunat, të lëshuar nga Ministria e Financave me nr. të protokollit 1171 të datës 08. 08. 2019. "Ne si drejtori së shpejti do t'i lëshojmë edhe instruksionet për procesin e planifikimit buxhetor si gjithmonë do të jemi të gatshëm për bashkëpunim dhe në dispozicion. Do t'i mbajmë takimet konsultative me secilin drejtor për shqyrtimin e kërkesave fillestare buxhetore për vitin 2020 dhe parashikimet



për vitin 2021 dhe 2022 gjatë kësaj jave", ka thënë Fazliu.

Si shqetësim i ngritur gjatë kësaj mbledhje ishte edhe mosfurnizimi me kohë i drejtorive komu-

nale me printerë nga kompania e re e kontraktuar "N. T. INFO COM" nga Autoriteti Qendror i Prokurimit, me ç'rast kryetari Bahtiri u shpreh i shqetësuar për

mos implementimin e kontratës pasi që mosfurnizimi me printerë na ka sjellë vështirësi të shumta gjatë kryerjes së punëve të përditshme në shërbim të qytetarëve tanë.

Në këtë mbledhje të bordit u diskutua edhe për sukseset e arritura nga vajzat e Klubit të Futbollit KFF "Mitrovica" të cilat po shkruajnë historinë në arenën ndërkombëtare të futbollit. Me këtë rast, Bordi i Drejtorëve aprovoi kërkesën e tyre e cila do të procedohet për Kuvendin Komunal për t'i mbështetur ato në shpenzimet e udhëtimit në vlerë prej 5 000 eurosh në ndeshjen e radhës në Gjermani.

Në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa të Rahovecit shqyrtohen disa vendime të kryetarit Latifi

RAHOVEC, 19 GUSHT (ER) - Nën kryesimin e kryesuesit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Afrim Dina, në prani të nënkryetarit të komunës, Fatmir Iska, anëtarëve të KPF-së, drejtorëve të drejtorive komunale, dhe Sead Rabës, përfaqësuesit të OSBE-së, të hënën është mbajtur mbledhja e tetë e rregullt e Komitetit për

Politikë dhe Financa në Komunën e Rahovecit për vitin 2019.

Pas diskutimeve nga anëtarët e KPF-së, për mbledhjen e radhës së kuvendit komunal u rekomanduan këto pika: shqyrtimi i propozimvendimit të kryetarit të komunës për dhënie të pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim

afatshkurtër personave fizikë dhe juridikë, shqyrtimi i propozimit të kryetarit të komunës për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, informatë mbi implementimin e planit për investime në hapësirat e hapura publike në Komunën e Rahovecit.



Veseli thotë se ministri Uran Ismaili ka bërë ndryshime në shëndetësi

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka lavdëruar punën e ministrit të Shëndetësisë Uran Ismaili. Sipas Veselit, me vendime të guximshme, Ismaili ka arritur të bëjë atë që nuk e ka bërë askush për dy dekada në shëndetësi. "Falë nismave antikorrupsion të ndërmarra nga kjo ministri, ne kemi garantuar çmime të njëjta në çdo barnatore, duke ua kursyer qytetarëve së paku 10 milionë euro. Po ashtu, kemi shmangur abuzimet me barnat që blihen nga spitalet, duke shpenzuar 6 milionë euro më pak", ka thënë Veseli



zgjedhja që duhet ta bëjnë qytetarët e Kosovës: t'i investojnë miliona euro në korrupsion apo miliona euro në investime konkrete. Duke bërë zgjedhjen e duhur, ne mund ta ndërtojmë një të ardhme më të mirë në vendin tonë", ka thënë Veseli.

Ai ka shtuar se vendosmëria e tij

dhe e PDK-së për ta luftuar seriozisht korrupsionin dëshmohej më së miri me punën e bërë në Ministrinë e Shëndetësisë. "Falë nismave antikorrupsion të ndërmarra nga kjo ministri, ne kemi garantuar çmime të njëjta në çdo barnatore, duke ua kursyer qytetarëve së paku 10 milionë

euro. Po ashtu, kemi shmangur abuzimet me barnat që blihen nga spitalet, duke shpenzuar 6 milionë euro më pak. Me këto para që kemi kursyer, ne kemi investuar në pajisje moderne, ambiente cilësore dhe kushte bashkëkohore për pacientët tanë", ka deklaruar Veseli.

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

Veseli ka thënë se me vendime të guximshme, ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka arritur të bëjë atë që nuk e ka bërë askush për dy dekada në shëndetësi. "Kështu ndodh kur vendosim njerëz të rinj në pozita udhëheqëse dhe u japim mundësi. Me gjashtë milionë euro të shpëtuar, duke luftuar korrupsionin në shëndetësi, ne tani çdo vit mund të investojmë më shumë dhe të ndërtojmë spitale të reja, të blejmë aparaturë të re dhe barna shumë më cilësore. Kjo është

PRISHTINË, 19 GUSHT - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka takuar të hënën përfaqësuesit e Odës së Farmacistëve të Kosovës, me të cilët ka diskutuar për gjendjen në shëndetësi. Ai ka theksuar se shembulli i shëndetësisë, që për herë të parë udhëhiqet nga PDK-ja, me të si kryeministër do të jetë modeli i luftës sonë kundër korrupsionit.

FSK-ja, pjesë e ushtrimit shumëkombësh në Gjermani

Gjatë këtyre ditëve të ushtrimit janë zhvilluar aktivitete të vazhdueshme në ngritjen dhe zhvendosjen e ritransmetuesve, sipas nevojave në mbështetje të operacioneve taktike të Batalionit të Parë Xhenier si dhe bashkëpunimit me Kompaninë e Komunikimit "Charlie"

PRISHTINË, 19 GUSHT (ER) - Një kontingjent i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) i përbërë nga 12 pjesëtarë që nga 9 gushti është duke marrë pjesë në ushtrimin fushor "Zgjidhja e Kombinuar XII" (Combined Resolve XII), në bazën e Ushtrisë Amerikane për Evropë (USAREUR) që gjendet në Republikën Federale të Gjermanisë. Ekipi i FSK-së në këtë ushtrim është duke mbështetur Brigadën e Parë të Blinduar Luftarake të Divizionit

të Këmbësorisë, në fushën e komunikimit, të personelit, të operacioneve si dhe në fushën e vëzhgimit dhe kontrollimit të zhvillimit të stërvitjes. Gjatë këtyre ditëve të ushtrimit janë zhvilluar aktivitete të vazhdueshme në ngritjen dhe zhvendosjen e ritransmetuesve, sipas nevojave në mbështetje të operacioneve taktike të Batalionit të Parë Xhenier si dhe bashkëpunimit me Kompaninë e Komunikimit "Charlie".

Ushtrimi "Combined Resolve XII" është ushtrim shumëkombësh i operacioneve të unifikuara tokësore, i drejtuar nga shtabi i Departamentit të Ushtrisë së ShBA-ve. Qëllimi i këtij ushtrimi është stërvitja e forcave të caktuara rajonale të Shteteve të Bashkuara të nivelit të Brigadës, në mbështetje të objektivave të Komandës Evropiane të ShBA-së për bashkëpunim dhe siguri, ndërtimin e gatishmërisë me aleatët dhe partnerët e NATO-s.



Ministri Gashi falënderon O'Connellin për përkrahjen e trashëgimisë kulturore

PRISHTINË, 19 GUSHT (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të hënën në takim lamtumirës ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar, Ruairi O'Connell, të cilin e ka falënderuar për përkrahjen dhe bashkëpunimin me MKRS-në. Ministri Gashi fillimisht e ka falënderuar ambasadorin O'Connell për kontributin e dhënë për vendin tonë dhe

përmes tij popullin britanik për ndihmën dhe mbështetjen e shtetit të tij për Republikën e Kosovës në përgjithësi, veçanërisht në fushat që mbulon MKRS-ja, sidomos në trashëgiminë kulturore. Gjatë këtij takimi ministri Gashi ka folur për bashkëpunimin e deritanishëm mes MKRS-së dhe ambasadës në aktivitete dhe projekte të shumta të për-

bashkëta, me këtë rast ministri i shprehu mirënjohje të përzemërt ambasadorit O'Connell. Ndërsa ambasadori O'Connell ka theksuar rëndësinë e trashëgimisë kulturore si dhe vazhdimin e bashkëpunimit me MKRS-në në këtë fushë. Ministri e uroi ambasadorin O'Connell për karrierën e tij në të ardhmen duke i dëshiruar suksese në punë dhe në jetë.



A është e përgatitur Kosova për ndryshimin e qeverisë?



Shkruan: Bedri ISLAMI

Kosova, si duket, po hyn në zgjedhjet parlamentare të jashtëzakonshme, menjëherë pas dorëheqjes së papritur të shefit të deritanishëm të qeverisë, Ramush Haradinaj. Koalicioni i drejtuesve të luftës, PDK-ja, AAK-ja dhe Nisma, që, thënë të saktën, nuk shkëlqej në fuqizimin e shtetit, do të mbahet mend si shansi që iu dha shokëve të vjetër, por edhe rivalëve të vjetër nga i njëjti burim, për ta sendërtuar shtetin e tyre, për të cilin ata kishin qenë në çaste të vështira në një strukturë të përbashkët çlirimtare. Personalisht kam pasur shpresë se do të kishin bërë shumë më tepër sesa vendosja e taksës 100 për qind ndaj produkteve serbe apo boshnjake; kam menduar se mes tyre do të kishte një ndërlidhje më të veçantë me shtetin shqiptar por, mbi të gjitha, me shtresat e popullsisë, të cilat ende sot janë në një gjendje jo të mirë financiare.

Kam besuar këtë, pasi, jo shumë larg në kohë, të tri forcat politike që qeverisnin, megjithëse janë shpallur të gjitha si forca të djathta, kishin dhe vazhdojnë të kenë mbështetjen politike dhe votuese të asaj shtrese të popullsisë që aspirojnë majtas. Shkurt, që është më e varfra në Kosovë. Dhe mjerisht, më e shumta!

Tani, pas pak ditësh, megjithëse duhet të ketë synuar për të gjetur një zgjidhje të minutës së fundit, çka është në natyrën e tij politike, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi do të shpallë shpërndarjen e parlamentit dhe datën e

zgjedhjeve të parakohshme politike, përmes të cilave mund të ketë një konfiguracion të ri politik qeverisë dhe nga të cilat, ata që drejojnë sot, nesër mund të jenë në opozitë.

Fillimi i tetorit mund të jetë dita e përbashkës politike, llogaritë e të cilave kanë filluar që tani. Partizat e vogla, pa asnjë lloj ndikimi në elektorat, por me dy a tre emra të njohur, po vrapojnë të sigurojnë një shpatull ku të mbështeten për të mbijetuar politikisht drejtuesit e tyre, ndërsa partitë e mëdha, herë haptas e herë mbyllasi, po planifikojnë koalicione të mëdha, para ose pas zgjedhore. Do të jetë njëra nga përbashkësitë më të ashpra në Kosovën e pasluftës, pasi do të kemi një trekëndësh politik, i cili nuk ka ekzistuar asnjëherë më parë në këtë shumësi përplasjesh.

Në njërin cep do të jetë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e drejtuar nga Ramush Haradinaj, kryeministri karizmatik i ditëve të fundit përmes dy veprimeve të gjetura politike, të cilat ndikojnë sidomos në zonat rurale; vendosja e taksës ndaj produkteve serbe dhe tërheqja nga posti i kryeministrit menjëherë sapo është thirrur nga Gjykata Speciale. Kjo e fundit, e përsëritur edhe kur ai ishte kryeministër herën e parë, sjell një dëshmi të fortë: gjithëherë ai ka menduar më parë për shtetin e Kosovës e më pas për fatin e tij personal. Të paktën kështu do të konceptohet nga njerëzit që e duan atë apo që duan të shkojnë pas tij.

Në cepin tjetër do të jenë VV e Albin Kurtit dhe LDK e Isa Mustafës. Të dyja në opozitë. Njëra e paprovuar dhe ka të drejtën e provës, tjetra e provuar dhe jo me shumë skandale, por as me ecuri. Një qeverisje hije që, si hyri, ashtu edhe doli. Por që nuk la skandale pas vetes. Vetëvendosja! është forca politike më kariz-

matike në Kosovë, jo vetëm për hir të liderit të saj, por edhe nga që në shumësinë e saj ajo përbëhet nga njerëz aktivë, të lidhur me njëri-tjetrin, të disiplinuar dhe që, shumë shpejt, nga një forcë politike e hapur, mund të kthehet në një forcë qeverisëse autoritare.

Albin Kurti është sot drejtuesi më karizmatik i forcave politike në Kosovë. I parratur nga breshëri i pushtetit ai ka përparësinë e premtimit, pa dhënë llogari. Më elokuent se të tjerët, i lëvizshëm në ecurinë e tij drejt njerëzve, i rrethuar nga një grup besnik që nuk e braktisi në ditët e ndarjes me ndjekësin e tij më të afërt, Molliqajn, kritikues i pareshtur i qeverisjes së Kosovës, por edhe në Shqipëri, i gatshëm për aleanca me të gjithë ata që janë kundër Thaçit, prishja me të cilin daton që nga ditët e Rambujesë, i gatshëm të bashkohet me Mustafën, të cilin e ka shembur politikisht kur ishte ky i fundit kryeministër.

Në rrjedhën e përbashkët është edhe LDK-ja, drejtuesi i secilës, përmes një statusi i rangoi të gjithë të tjerët se si ish-in sjell me të, si e kishin etiketuar, si e kishin bërë tradhtar, por dorën ua shtrin së pari VV.

Cepi i tretë janë të njohurit e vjetër, dikur anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, më pas të zemëruar, por sërish së bashku, PDK-ja e Veselit dhe Nisma e Limajt. Është e mundur një koalicion parazgjedhor mes tyre nga i cili Nisma, në rastin e një koalicioni, mund të ketë më shumë se 10 deputetë, sidomos kur ka si drejtues të Grupit Parlamentar Bilall Sherifin, më i afti në mesin e tyre. PDK-ja, dikur forca politike kryesore në Kosovë, e lodhur nga barra e pushtetit, nga i cili ka marrë vetëm pasojat, por jo arritjet, vetëm përmes këtij koalicioni mund të jetë forcë e parë, por

do të humbë në numrin e deputetëve të saj.

Fushata ende nuk ka filluar, data e zgjedhjeve nuk dihet ende, asnjë program nuk është shpallur, asnjë takim nuk është bërë dhe, për një post të vetëm, atë të shefit të qeverisë, synojnë katër drejtues. Si të thuash katër bejlerë për një derë.

VV, e cila synon të jetë forcë e parë politike, synon edhe shefin e qeverisë. Të gjithë drejtuesit e saj, pas Kurtit, e kanë shpallur kredon e tyre. Albin duhet të jetë kryeministër.

LDK-ja, e cila mendohet të jetë pjesë e koalicionit VV-LDK, para ose pas zgjedhor, nuk heq dorë nga posti i shefit të qeverisë. Kredo e shpallur e tyre është që kryeministri duhet të jetë i tyre dhe pikë. Kryetari i grupit parlamentar, dikur aspirant për kryeministër, i përkrahur edhe nga Lutfi Haziri, dora e fortë e LDK-së, kanë shpallur se nuk heqin dorë nga posti kryeministër dhe ky është kusht i panegociueshëm.

AAK-ja e Ramush Haradinajt, i cili sapo hoqi dorë nga posti i kryeministrit, e ka synim që gjërat të përsëriten. Është shumë e mundshme që falë figurës karizmatike të Haradinajt, në fakt njëri nga burrat që fjalën e dhënë e ka të shenjtë, numri i atyre që duan të votojnë për të, jo thjeshtë për partinë e tij, të rritet dhe pjesëmarrja e tij në qeverinë e ardhshme të jetë e domosdoshme. Do të pranojë ai më pak se posti kryeministër - kjo do të shihet në të ardhmen.

Shumë kush në Kosovë mendon se ai, nëse do të kishte hapësirë më të madhe politike, do të ishte shefi i qeverisë më aktiv. I zënë në kurthin e partive politike koalicioniste të deritashme ai lejoi që aparati të ngjishet nga njerëzit e shumtë dhe ku zëvendësministrat të ishin si

farë liri. Në VV kësaj i tremben më shumë, figurës së tashme të Haradinajt dhe kjo e detyroi një mik të tij të vjetër, Rexhep Selimin, tani në VV, që të deklaronte se "heshtja para gjykatës speciale, që kishte zgjedhur Haradinaj, ishte në dëm të Kosovës". Ndoshta një ditë do të pyetet edhe Rexhep Selimi dhe njerëzit do të donin të dinin përgjigjet e tij.

PDK-ja, kësaj here, përmes zërit më intelektual të saj, Enver Hoxhaj, deklaroi se nuk do të ketë më kryeministra me qira, por edhe deri tani, nga tre postet themelore, dy kanë qenë të PDK-së, ai i presidentit dhe i kryetarit të Kuvendit, që është edhe drejtuesi i PDK-së, zoti Veseli.

Katër ëndrra për një post. Katër bejlerë politikë në një derë qeveritare!

Ende pa filluar fushata, gjithçka po sillet rreth shefit të ardhshëm të qeverisë. Të duket sikur partitë politike në Kosovë, më shumë se për gjithçka tjetër, janë të interesuara se cila prej tyre do të ketë shefin e qeverisë, cili nga liderët do të jetë në tryezën kryesore të shtetit, përmes së cilës lëvizin tenderët, rryshfeti, emërimet, hatërlleqet, sundimi mbi ligjin, pasurimi dhe harresa ndaj të tjerëve.

A është e nevojshme që Kosova të ketë një strukturë tjetër qeverisjeje? A mund të vazhdohet edhe më tej përmes këtij koalicioni qeverisës, i cili, edhe pse kishte në përbërjen e tij figura të dëshmuara gjatë luftës, nuk arritën të ndërtojnë paqen?

Kosova është para dy ngjarjeve të mëdha, të cilat, edhe pse duket se e përjashtojnë njëra tjetrën, takohen në qeverisjen e vendit: zgjedhjet e reja politike dhe gjykata speciale!

Gjithçka është ende në fillimin e lojës. Pritet vetëm sinjali i dhënë nga presidenti Thaçi, veç nëse ai mund të ketë menduar diçka tjetër dhe, si zakonisht, të jetë një hap para të tjerëve.

Kurti pret në takim lamtumirës ambasadorën e Kroacisë

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka pritur sot në takim lamtumirës ambasadorën e Kroacisë Marija Kapitanović dhe sekretarin e parë të kësaj ambasade, Zlatko Vnuçec.

Kurti e ka falënderuar Kapitanović për bashkëpunimin gjatë shërbimit të saj dhe i ka uruar suksese në angazhimet e tjera të radhës.

"Përgjatë bisedës u theksua

rëndësia e institucionalizimit të mëtutjeshëm të marrëdhënieve bilaterale mes dy shteteve tona. Po ashtu, u diskutuan përvojat e Kroacisë në forcimin e saj ligjor e demokratik dhe ndihma e mbështetja e Kroacisë në shtetndërtimin e Kosovës. Kryetari Kurti përsëriti nevojën e vendit tonë për një qeveri të re e cila do t'i intensifikojë marrëdhëniet ndër-shtetërore me vendet aleate e

partnere, veçanërisht me Kroacinë", është theksuar në njoftimin e LV-së.

Sipas këtij njoftimi, në fund të takimit, Kapitanović shprehu dëshirën e saj për t'i ndjekur edhe më tej zhvillimet politike në Kosovë sidomos në këto kohëra interesante, ndërkaq zyrtarët e Lëvizjes shprehën gatishmërinë që të vazhdojnë bashkëpunimin me pasuesin e ambasadores.



Vazhdon greva në ANP 'Adem Jashari'

Punëtorët e Sindikatës së Pavarur të Punëtorëve në aeroportin "Adem Jashari" do ta vazhdojnë grevën edhe sot (e martë), duke filluar nga ora 08:00 deri në orën 10:00, ndërsa të mërkurën është paralajmëruar grevë tetorëshe. Lidhur me grevën, Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës (AACK) ka bërë thirrje që të bisedohet për të gjetur zgjidhje të pranueshme në aeroportin "Adem Jashari"



AACK-ja: Të bisedohet për të gjetur zgjidhje të pranueshme në aeroportin 'Adem Jashari'

Inspektorët e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës (AACK) gjatë kohës së grevës kanë vëzhguar nga afër vijimin e operimeve të linjave në pajtim me rregullat dhe standardet e zbatueshme për siguri të operimeve dhe nuk

kanë vërejtur parregullsi. "Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës edhe një herë u bënë thirrje të gjitha palëve që t'i shfrytëzojnë të gjitha mundësitë e dialogut social për të gjetur një zgjidhje të pranueshme për palët. U

bëjmë thirrje udhëtarëve që t'i monitorojnë komunikatat e ANP 'Adem Jashari' dhe ta planifikojnë itinerarin e udhëtimit në koordinim të ngushtë me kompanitë ajrore apo përfaqësuesit e tyre", thuhet në njoftimin e AACK-së.

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 19 GUSHT - Punëtorët e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" kanë mbajtur të hënën një grevë njëorëshe e cila ka shkaktuar tollovi dhe vonesa për fluturime. Punëtorët nëpërmjet kësaj greve po kërkojnë kompensim dhe përfitime të tjera për rrezikshmërinë, eliminimin e dallimeve në paga, pagesën e përvojës së punës, që orët e punës gjatë fundjavës të paguhen sipas Ligjit të punës dhe t'u bëhet pagesa e shujtës.

Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Aeroportit të Prishtinës, Bashkim Latifi, ka deklaruar se greva ka shkuar ashtu siç edhe është planifikuar. Ai ka thënë se përmes kësaj greve kanë dërguar mesazhet te menaxhmenti i Aeroportit të Prishtinës. Latifi ka paralajmëruar se nëse nuk reflektojnë karshi kërkesave të tyre, greva do vazhdojë sot (e martë) dhe të mërkurën.

Ndërsa për pengesat dhe vonesat në procesin e punës së aeroportit, zëdhënësja e Aeroportit, Valentina Gara, ka thënë se janë shkaktuar vonesa, pasi që një grevist ilegalisht e ka ndërprerë shiritin e bagazhit dhe kjo pastaj ka shkaktuar telashe. "Përkundër grevës, sot fluturimet ishin duke u operuar normalisht, por duke parë këtë mbarëvajtje të fluturimeve dikush nga punonjësit ilegalisht ka shtypur butonin emergjent të shiritit të valixheve dhe në këtë mënyrë ka penguar operimet. Po ashtu, duke iu përgjigjur kërkesave të sindikatës, edhe pse me shkrim i kemi njoftuar për secilën veç e veç, ne përsëri ju njoftojmë se sa i përket kërkesës së dialogut me menaxhmentin, qysh nga fillimi e kemi caktuar menaxherin e lartë të burimeve njerëzore për komunikim me sindikatë, mirëpo këta të fundit vazhdojnë ta injorojnë pozitën e tij dhe hezitojnë të takohen me të duke e quajtur atë si ulje të nivelit të bisedimeve", ka thënë Gara.

Nisin takimet për privatizimin e Telekomit

PRISHTINË, 19 GUSHT (ER) - Ministri në detyrë i Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Valdrin Lluka, ka pritur të hënën në takim përfaqësues të kompanisë "Detecon International GmbH" dhe të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), me të cilët ka biseduar për gjendjen në Telekom dhe privatizimin e kësaj ndërmarrjeje. Në këtë takim është diskutuar lidhur me hapat që do të ndërmerren në të ardhmen, për planin e projektit dhe, po ashtu, është diskutuar për vendet që kanë pasur privatizim të suksesshëm e që duhet të krahasohen me vendin tonë sa i përket privatizimit të Telekomit të Kosovës.

Me këtë rast, kreu i MZHE-së, Valdrin Lluka, ka thënë se privatizimi i 51 për qind të aksioneve të Qeverisë së Kosovës në Telekom do të ndikojë në për-

mirësimin e kualitetit të operimit e, gjithashtu, do të ndikojë në zvogëlimin e humbjeve dhe do të rrisë efikasitetin e Telekomit. "Qeveria e Kosovës është e interesuar ta privatizojë pjesën vendimmarrëse të Telekomit, rreth 51 për qind duke qëndruar aksionarë për pjesën tjetër dhe kështu do të ndikojë në përmirësimin e kualitetit të operimit, gjithashtu do të ndikojë në zvogëlimin e humbjeve dhe do ta rrisë efikasitetin e Telekomit", u shpreh Lluka.

Ai ka falënderuar Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për përkrahjen që ka dhënë në këtë proces, me ç'rast ka ndikuar edhe në rritjen e besueshmërisë dhe transparencës së këtij procesi të ndjeshëm për vendin. "BERZh-i me kërkesën tonë ka financuar në formë të grantit dhe ka përzg-



jedhur kompaninë 'Detecon', degë e kompanisë 'Deutsche Telekom', që ta përgatisë Telekomin për privatizim, pro-

jekt i cili do të zgjasë rreth pesë muaj", ka thënë Lluka. Ekipi nga kompania "Detecon International GmbH", gjatë qën-

drimit në Kosovë, është takuar me aktorë që ndërlidhen me këtë ndërmarrje të rëndësishme për ekonominë e vendit.

Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (21)

ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDER I KOMBIT

- Përshtypjet në "librin e zisë"



**Përgatiti: Selatin
NOVOSELLA**

Kryeideatori legjendar i të gjitha kryengritjeve çlirimtare në Kosovë, yll i pashuar, jo vetëm i Kosovës por edhe i krejt kombit shqiptar. Lavdi e përjetshme! Mbetet i pavdekshëm heroizmi i Bacës Adem!

30 korrik 2018,
Rifat Blaku

Respekt Bacë Ademit, këtij njeriu të veçantë, i cili pjesën më të madhe të jetës ia kushtoi lirisë së Kosovës dhe popullit të vet! Baca nuk luftoi vetëm për lirinë e popullit shqiptar, por për lirinë e njerëzimit! Ai ishte luftëtar i vërtetë për lirinë e njeriut!

30 korrik 2018,
Ramadan Sopa

Përfaqësues, punëtor të Hotelit Grand! Kemi ardhur të shprehim respektin tonë për veprën e pavdekshëm të Bacës Adem Demaçi! Lavdi i qoftë përherë!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Baca ishte i pakrahasueshëm me qëndresën unike të tij! U shpërblje për së gjalli me preken e lirisë së Kosovës! Mos u harroshin vuajtjet e tij asnjëherë!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Jemi kombi më me fat që të patëm, Bacë! Gjithmonë i gjallë do mbetesh në mesin tonë! Lavdi!

30 korrik 2018,
F. Morina

Politika të izoloi, kombi të nderoi, sepse ju keni vulosur kohën dhe kjo vulë mbetet në historinë e lëvizjes çlirimtare të popullit tonë! Lavdi të qoftë Bacë!

30 korrik 2018,
Afrim Morina

Një jetë në luftë dhe me luftë! Jetë plot stuhi dhe qëndresë, për të cilën ta kanë lakmi edhe heronjtë më të mëdhenj! Lavdi të qoftë, Bacë!

30 korrik 2018,
Mirlind dhe Burbuqe Bruçi

Respektin e të respektuarve ta solli vepra Jote, Baca Adem! Gjatë do të jetoj kujtimi për ty dhe veprën tënde! Lavdi!

30 korrik 2018,
Beqir Hoxha

Të gjithë jemi të vegjël përballë veprës Tënde madhështore! Amaneti yt për një shtet të së drejtës është obligim për ne! Lavdi!

30 korrik 2018,
Gjykata e Apelit e Kosovës

I përhershëm do mbetet kujtimi për ju Baca Adem Demaçi! Zor të gjejmë fjalë për të përshkruar veprën tuaj! Lavdi të qoftë!

30 korrik 2018,
Zenun Halili

Ngushëllime për Bacën tonë të madh, luftëtarin e patrembur të lirisë. Ngushëllime për Heroin e Kosovës. Kolos do mbetet gjithmonë!

30 korrik 2018,
Driton Mazreku

Me ty Baca Adem filluam rrugën e dritës nga fundi i një tuneli të gjatë! Një rreze që depërtonte nga fundi, doli të jetë shpresë lirie. Ishe ti Bacë që rrezatoje shpresë! Kosova dhe gjithë shqiptaria do të vazhdoi rrugëtimin për realizimin e amanetit tuaj për bashkim kombëtar!

30 korrik 2018,
Xhemal Aliu

Për Ty Bacë është pak ose hiq të flasim, se s'ka fjali që gjendet në këto momente, kur kemi ardhur për ngushëllime. Nuk do ta harrojmë për së gjalli një kujtim për ty kur ishe tek unë në banesë në Gjenevë. Shumë këshilla na dhe atë ditë, dhe për këtë do t'u jemi mirënjohës përjetë! I lehtë të qoftë dheu i Kosovës!

30 korrik 2018,
Basri Misini

Ky kolos i shqiptarisë, sado që të mendoj ndokush që ka vdekur, le ta dinë të gjithë se Baca nuk vdes kurrë!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Lavdi për mësuesin tonë të kombit, Bacën Adem Demaçi!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Baca Adem sa ishte gjallë na bashkoi për liri dhe rezistencë

dhe tash na bashkon me veprën e tij për të realizuar amanetin e madh për jetësimin e shtetit të së drejtës!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Baca Adem sfidoi çdo vështirësi me të cilën u përballë! Me shembullin e Tij ai u bë mësues për çdo njeri lirisdashës!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Bilbili, që të lindi Kosova, ka emrin Adem Demaçi. E ka emrin Adem, Burri i burrave të sakrificës për lirinë e Kosovës dhe bashkimin e saj me Shqipërinë (mëmë)! Prehu në paqe, o njeri i mirë!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Ishe dhe do të mbetesh ikona e kombit shqiptar! Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës!

30 korrik 2018,
Mexhid Syla

Baca Adem, të lumtë që ke vuajtur për këtë popull! Besoj që keni bërë një burg të ndershëm. Besoj se nuk keni lenë pas diçka që nuk ju takon juve!

30 korrik 2018,
Nezir Selmani (Zharku),
Prishtinë

Baca Adem, sot, erdhëm me dhembje të madhe, por edhe me krenari që të patëm, qytetar dhe të burgosur politik, nderuam familjen tuaj dhe u shprehëm ngushëllime! Veprën tënde e mbron populli dhe nderimin për ty e ruan thellë në zemër!

30 korrik 2018,
Xhevat Haziri

Ishe dhe do të mbetesh i veçantë, sepse i tillë linde, u rrite dhe na mësove si duhet atdheu! Lavdi jetës dhe veprës tënde, Baca Adem Demaçi!

30 korrik 2018,
Sheremet Pantina

Ishe Mendela i Evropës, kolosi, vizionari, simboli i qëndresës! Të qoftë i lehtë dheu, i respektuari i Kosovës, baca Adem!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Ishe dhe mbete i përjetshëm me vepër! Lavdi e përjetshme për sakrificën tuaj sublime!

30 korrik 2018,
(pasojnë tre nënshkrime të palexueshme)

Jo më kot të quajnë; nderi i kombit! Lavdi veprës tënde, Baca Adem!

30 korrik 2018,
Arsim Emiri

Respekti për ty, Bacë do jetë i përjetshëm!

30 korrik 2018,
Dr. Temi

Respekt për kolosin e kombit, Bacën Adem, i cili zë vend të posaçëm në historinë kombëtare!

30 korrik 2018,
Ismail Misini

Respekt për personalitetin dhe veprën tuaj të pakapërcyeshme!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Vepra jote do mbetet dëshmi për shekuj të tërë, Baca Adem!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Ashtu siç thoshit Ju, Baca Adem; vdekje nuk ka, pasi që jeta vazhdon edhe pas vdekjes, njerëzit si Ju na e mësojnë këtë që po e shohim! Ju do mbeten gjatë me të gjallë!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Baca Adem, ti ishe dhe do mbetesh i pavdekshëm në memorien e çdo atdhetari, do mbetesh shtyllë e fortë e historisë më të re të kombit shqiptar! Lavdi të qoftë për jetë e mot!

30 korrik 2018,
Nazif Gashi dhe familja

Baca Adem, jemi krenar që të patëm! Do mbetesh gjithnjë në kujtimet tona! Pusho në paqe!

30 korrik 2018,
Mësuesja Xhevrije (mbiemri i palexueshëm)

Amaneti tt Bacë, do mbetet porosi dhe obligim atdhetar për çdo brez! Ti sakrifikove aq shumë, andaj obligimi është borxh i rëndë! Lavdi të qoftë!

30 korrik 2018,
Mejreme Shema

Nëse dikujt i përket epiteti madhështor, ti je ai, baca Adem! Porositë tuaja janë mësim për çdo atdhetar! Të tilla do mbesin përherë!

30 korrik 2018,
Familja Sejdiu, Gani Sejdiu,
Prishtinë

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)



E rrallë

Në një fshatë të Polonisë lindin vetëm vajza

Në Poloni është një fshat ku prej nëntë vjetësh nuk ka lindur asnjë djalë. Bëhet fjalë për fshatin Odrzanskië, i cili në total ka 270 banorë. Pikërisht për këtë lajm, ky fshat kohët e fundit është bërë shumë i famshëm, duke marrë vëmendjen e shumë medie ve ndërkombëtare. Djali i fundit në këtë fshat ka



lindur para nëntë vjetësh, ndërsa kreu i fshatit ka ofruar edhe një shpërblim për çiftin që do të lindë djalë.

FOTO E DITES



Një djalë afgan shihet duke kërkuar ushqim në mesin e mbeturinave. /AP/

E jashtëzakonshme

Zemra e derrave do të transplantohet te njerëzit brenda tre vjetëve

Zemra e derrave mund të përdoret për transplantim te njerëzit brenda tre vjetëve. Lajmi u dha nga kirurgu Sir Terence English që kreu transplantimin e parë të zemrës te njerëzit e 40 vjetëve

më parë në Britaninë e Madhe. Duke folur në 40-vjetorin e operacionit të parë të zemrës, English ka pohuar se po synon ta zëvendësojë edhe veshkën e njerëzve me atë të derrave këtë vit.



BARSOLETA E DITËS



E kam një parfum që e përdori që pesë vjet vetëm kur dalë me femra. Një e keqe është se parfumi është i ri, sepse ende nuk e kam hapur.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 15:30 The Angry Birds Movie 2 (3D)

Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 39 min
Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj, etj.

Regjia: Thurop Van Orman



Në ora 17:30

GOOD BOYS

Aventurë/Komedi; 1 orë 29 min

Rolet: Jacob Tremblay, Keith L. Williams, Brady Noon, Molly Gordon, Lil Rel Howery, Will Forte, etj.

Regjia: Gene Stupnitsky




Çdo ditë në ora 19:15

“HOBBS & SHAW”

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.
Regjia: David Leitchu




Çdo natë në ora 21:30 ONCE UPON A TIME IN HOLLYWOOD

Komedi/Dramë; 2 orë 41 min

Rolet: Leonardo DiCaprio, Brad Pitt, Margot Robbie, Al Pacino, etj.

Regjia: Quentin Tarantino



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

 <p>DASHI Sot do t'i korigjoni disa veprime të nxituara që keni marrë në të shkuarën. Janë gjëra që mund t'ju prishnin shumë punë nëse nuk zgjidheshin.</p>	 <p>DEMI Në ambientet që frekuentoni vazhdimisht do të gjeni njerëz që ndajnë të njëjtat ide si ju. Bashkë mund të bënit një skuadër fituese në çdo gjë.</p>	 <p>BINJAKËT Sot jeni i justifikuar nëse shpenzimet tuaja kanë për qëllim dhurata për personat e dashur. Gjithmonë ju kanë akuzuar se jeni egoist në shpenzime.</p>	 <p>GAFORRJA Fantazia e shfrenuar sot do t'ju ndihmojë të harroni për pak çaste problemet që jua kanë mbushur ditën. E keni gjetur si rrugë shpëtimi këtë gjë.</p>	 <p>LUANI Sot, edhe pse nuk keni qejf të punoni, shumë alternativa interesante do ta zgjojnë tek ju ambicien e dikurshme. Do t'i tregoni vetes që ia dilni me pak punë.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Edhe pse në familje ka debate, ju do të dini se si ta riktheni harmoninë e dikurshme. Çdo gjë do të qetësohet gjatë pjesës së dytë të ditës.</p>
 <p>PESHORJA Sonte nuk keni pse mërziteni sepse keni marrë disa ftesa shumë interesante. Ju mjafton vetëm të zgjidhni se ku do të shkoni.</p>	 <p>AKREPI Argëtohuni sot duke hequr mendjen nga gjithçka që ju ka shqetësuar kohët e fundit. Miqtë do të dinë se si t'ju bëjnë t'i harroni problemet.</p>	 <p>SHIGJETARI Disa keqkuptime të vogla do ta ndryshojnë komplet thelbin e bisedës sot. Nuk do të jeni në gjendje të sqaroni atë çka donit të thoshin.</p>	 <p>BRICJAPI Këshillat e mira merren gjithmonë në konsideratë. Këtë do të bëni edhe ju sot sepse e dini mjaft mirë që personat që po jua japin jua duan të mirën.</p>	 <p>UJORI Doni të niseni sa më parë në udhëtimin që keni planifikuar dhe dita e sotme ju favorizon për këtë gjë. Shijoni çastet larg punës suaj.</p>	 <p>PESHQIT Tensione në vendin tuaj të punës që nuk ju lënë rehat, por nga ana sentimentale gjithçka shkon mirë dhe partneri është mbështetësi juaj kryesor.</p>

Liam Hemsworth pas ndarjes kalon më shumë kohë me miq

Aktori Liam Hemsworth, pas ndarjes me gruan Miely Cyrus, është duke u shoqëruar më shumë me miqtë e tij. Sipas "People", aktori ditët e fundit është parë në barin "Byron Bay" në Australi. Gjatë kësaj kohe ai ishte i shoqëruar me miqtë e tij. Gjersa Liam qëndron me miqtë, Miley ka filluar lidhje të re të dashurisë.



Përfundojnë pushimet për Justinin dhe Haileyn



A ta po shijonin disa ditë larg punës dhe përgjegjësive të përditshme, por të gjitha gjërat e mira duhet të marrin fund. Justin Bieber, 25 vjeç, dhe

gruaja e tij Hailey Bieber, 22 vjeçe, të dy kanë ndarë një fotografi të bukur të veten në rrjetet sociale për ta shënuar fundin e pushimeve të tyre.




Bella dhe The Weeknd sërish të ndarë

Bella Hadid dhe The Weeknd duket se kanë një krizë në marrëdhënien e tyre. Mediat e shoubizit thonë se ata janë ndarë përfundimisht, por një burim ka treguar se ata janë bashkë dhe se punojnë për t'i zgjidhur prob-

lemet. Por, mesa duket, këto probleme nuk janë zgjidhur aspak. Kur The Weeknd ka hyrë në klubin që Bella kishte shkuar me shoqet, kjo e fundit është larguar vetëm pak minuta më vonë. Kjo tregon se Bella nuk e duron dot praninë e tij.

A është duke realizuar këngë të re Rihanna pas shumë kohësh?



Këngëtarja dhe afaristja e njohur Rihanna ka tre vjet që nuk është marrë me muzikë që nga albumi i fundit "Anti". Adhuresit e saj mezi presin që ajo të publikojë ndonjë projekt të ri edhe në fushën e muzikës dhe jo vetëm në atë të biznesit. Një grup i adhuresve të saj me anë të një postimi në rrjetin social "Twitter"

kanë thënë se këngëtarja është duke punuar një këngë të re e cila quhet "Private Loving". Sipas këtyre informacione "Hollywood Life", shton se teksti i këngës është shkruar nga artisti Demarco dhe Monique Lawz. Kështu ka mbetur të shihet ditët në vijim se a janë të vërteta këto informacione për këtë këngë.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Beqiri: Fitorja ndaj Gjilanit, motiv për ndeshjet e tjera

Portieri Arben Beqiri është i lumtur se Trepça '89 e mposhti skuadrën e Gjilanit me rezultat bindës. "Po, ishte një fitore shumë e rëndësishme për ne, kundër një skuadre shumë të fortë siç është Gjilani. Them të drejtën, nuk e kemi pritur një fitore me rezultat kaq të thellë, por duke e ditur se do të jetë vështirë, ne kemi besuar se mund ta fitojmë ndeshjen. Me angazhim dhe disiplinë ia kemi arritur këtij qëllimi", ka thënë Beqiri



EPOKA ERE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 19 GUSHT - Skuadra e Trepçës '89 e deklasoi Gjilanin duke e mposhtur me rezultat 4-1 në ndeshjen e parë të IPKO Superligës së Kosovës në futboll. Portieri Arben Beqiri të hënën për "Epokën e re" ka thënë se fitorja ka qenë e meritur dhe e pritshme, por jo me rezultat bindës. "Po, ishte një fitore shumë e rëndësishme për ne, kundër një skuadre shumë të fortë siç është Gjilani. Them të drejtën, nuk e kemi pritur një fitore me rezultat kaq të thellë, por duke e ditur se do të jetë vështirë, ne kemi besuar se mund ta fitojmë ndeshjen. Me angazhim dhe disiplinë ia kemi arritur këtij qëllimi", ka thënë Beqiri, i cili beson se këto tri

pikë në fillim të kampionatit do të jenë motiv i madh për skuadrën në ndeshjet e radhës.

Pas tri pikëve që mori në ndeshjen e parë të edicionit 2019/2020, skuadra e '89-shit synon edhe një tjetër rezultat pozitiv nga udhëtimi në Vushtrri, të cilin do ta bëjë gjatë fundjavës në kuadër të xhiros së dytë në elitë. Numri një në portën e skuadrës nga Mitrovica e lavdëron skuadrën e Vushtrrisë për traditën dhe cilësinë që ka, por është optimist për suksesin e radhës nga skuadra e tij. "Ndeshja e radhës do të jetë e vështirë, duke pasur parasysh që kemi të bëjmë me një ekip me traditë dhe cilësi. Ne do t'i bëjmë përgatitjet dhe do t'i qasemi ndeshjes siç është më se miri dhe të marrim rezultat pozitiv edhe në Vushtrri", ka shtuar Beqiri.

Ish-kampionia e Kosovës në futboll, Trepça '89, në këtë edicion po drejtohet nga trajneri Shpëtim Idrizi, i cili ka qenë kapiten dhe shtyllë e skuadrës për shumë vite. Portieri Beqiri e lavdëron punën e trajnerit të ri dhe beson se rezultatet nën udhëheqjen e tij nuk do t'i mungojnë Trepçës '89. "Shpëtimi ka bërë një punë të shkëlqyeshme deri me tani dhe jemi shumë të kënaqur me të. Si rezultat i punës së mirë ka ardhur edhe fitoja ndaj Gjilanit. Shpresojmë dhe besojmë se do të vazhdojmë me këtë ritëm dhe me këto rezultate pozitive edhe në vazhdim", ka deklaruar ai.

Arben Beqiri është një nga lojtarët kryesor në skuadrën e '89-shit, po ashtu edhe një ndër portierët më të mirë në futbollin e Kosovës.

SHKURT

Për 15 minuta shiten biletat e ndeshjes Kosovë - Çeki

Biletat për ndeshjen kualifikuese të Kampionatit Evropian "Euro 2020" në mes të Kosovës dhe Çekisë janë shitur në kohë rekorde. Kanë mjaftuar vetëm 15 minuta që të shiten të gjitha biletat për ndeshjen që zhvillohet më 7 shtator në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Futbollistët "Dardanë" do ta kenë përkrahjen e 12 500 shikuesëve edhe në ndeshjen ndaj Çekisë sikurse që e kishin deri tash. Kosova është e treta në Grupin A me 5 pikë të grumbulluara.

Ribashkohen KB Prishtina dhe 'Sigal'

Pas një viti bashkohen KB Prishtina dhe kompania e sigurimeve 'Sigal'. KB Prishtina ka njoftuar se është arritur marrëveshja që kompania e sigurimeve "Sigal" të jetë sërish sponzor e skuadrës "bardhekaltër". "Po ju prezantojmë transferimin më të fuqishëm në historinë e klubit. Pas vetëm një viti mungesë, kompania kampione e sigurimeve në vend, rikthehet në follenë e kampionëve. 'Sigal' vazhdon mbështetjen e klubit në rrugëtimin drejt sukseseve të ardhshme në Ligën e Kampionëve duke bartur emrin që është bërë sinonim i bashkëpunimit. Kampionët ribashkohen!", thuhet në njoftimin e KB Prishtina.

Zekiqi përforcon KB Ylli

KB Golden Eagle Ylli e ka bërë të hënën zyrtar transferimin e basketbollistit të njohur, Samir Zekiqi. Skuadra nga Suhareka beson se basketbollisti Zekiqi do të jetë një armë e fortë për klubin në edicionin e ri 2019/2020. "Basketbollisti mitrovicës Samir Zekiqi është pjesë e klubit tonë. Përfaqësuesi i Kosovës, që njihet si lojtar i qëndrueshëm dhe jo me formë labile, do të jetë një nga ata që do të dominojnë në trapez. Ne jemi të gëzuar që në formacionin tonë do ta kemi Samirin", thuhet në njoftimin e KB Ylli.

Roma e kërkon Mustafin

AS Roma është në kërkim të një mbrojtësi dhe anëtar i Arsenalit, Shkodran Mustafi, po shihet si një zgjidhje ideale. Mustafi mund të largohet nga Arsenal, pasi vendi i titullarit nuk është i sigurt, derisa Roma preferon ta marrë një vit huazim me mundësi blerje në vitin tjetër. Mustafi ka luajtur në të kaluarën për Valencian, Sampdorion dhe Evertonin.

Deputeti Gani Dreshaj ndihmon KF Dukagjini

PRISHTINË, 19 GUSHT - Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Gani Dreshaj, ka ofruar mbështetje për KF Dukagjini nga Klina. Ai ka bërë me dije se KF Istogu mbetet skuadra e tij e zemrës, por edhe Dukagjini do ta ketë përkrahjen gjatë tërë këtij sezoni në Superligë. "Pata

nderin dhe kënaqësinë që t'i ofroj donacion përkrahës klubit të Superligës, Dukagjini nga Klina. Bashkë me kryetarin e Klinës, Zenun Elezajn dhe një nga përfaqësuesit e skuadrës, u pajtuam për bashkëpunim dhe përkrahje gjatë tërë këtij sezoni. Më pas, bashkë me

kryeministrin Haradinaj, ishim spektatorë në stadium në ndeshjen që KF Dukagjini e zhvilloi ndaj Ballkanit. Skuadra ime e zemrës mbetet KF Istogu, por do të jem fans i KF Dukagjinit në Superligë këtë edicion", ka shkruar Dreshaj në "Facebook".



Ferizaj krenohet me fitoren ndaj Dritës

FERIZAJ, 19 GUSHT - Skuadra e Ferizajt e nisi në mënyrën më të mirë edicionin e ri futbollistik në IPKO Superligë, pasi në ndeshjen e parë arriti fitore ndaj Dritës në Gjilan (0-1). Kjo skuadër paralajmëron se paraqitjet e mira dhe rezultatet pozitive synohen edhe në ndeshjet e tjera të radhës.

"Skuadra ka mbajtur stërvitjen e radhës, pas fitores së madhe në udhëtim ndaj Dritës, në javën e parë në IPKO Superligën e Kosovës. Atmosfera brenda klubit është e mrekullueshme dhe futbollistët së bashku me shtabin teknik dhe trajnerin kanë premtuar angazhim në çdo ndeshje, që të

arrijmë suksese që qyteti ynë dhe tifozët 'Ujqit' i meritojnë. Këta djelmossa na kanë bërë krenarë të gjithëve me paraqitjen e tyre, andaj edhe mbështetja jonë nuk duhet të mungojë në ndeshjet e radhës, që të vazhdojmë me rezultate pozitive", thuhet në njoftimin e Ferizajt.



Përurohët stadiumi ndihmës në Korishë të Prizrenit

PRIZREN, 19 GUSHT - Futbollistët e Komunës së Prizrenit do të kenë edhe një stadium të ri ndihmës. Në Korishë të Prizrenit u përuhua të hënën stadiumi ndihmës në Boka Boka nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, kryetari i Prizrenit, Mytaher Haskuka dhe kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi. Me këtë rast ministri Gashi konsideroi se me investimet që po bën MKRS-ja nëpër tërë Kosovën po krijohen hapësira të reja dhe mundësi shtesë për të interesuarit që të merren me sport, me theks me futboll. "Është një investim në kuadër të projekteve që realizon Ministria e Sportit për të krijuar hapësira për futbollistët tanë, për talentet e rinj. Ky është projekti jo i fundit që po investojmë në Komunën e Prizrenit. Kemi mjete të ndara edhe për stadiumin në Gjonaj në të cilin po presim të kryhen aspektet administrative nga ana e komunës dhe t'i fillojmë investimet në këtë stadium", u shpreh ministri Gashi. "Jam i bindur fuqishëm që ky stadium do ta ndihmojë Komunën e Prizrenit, sportistët e Prizrenit që të avancojnë më



tutje. Kemi bërë investime të shumta. Komuna e Prizrenit ka një memorandum me Ministrinë e Kulturës rreth 40 milionë euro. Presim që të gjitha këto investime të kryhen edhe në sport, në kulturë dhe në trashëgimi", ka thënë ministri Gashi. Ndërsa kryetari i FFK-së, Agim Ademi, falënderoi ministrin Gashi dhe përmes tij MKRS-në për mbështetjen dhe kujdesin në investimet që po bëjnë në fushën e sportit. "Nuk po rreshtin projektet e infrastrukturës së futbollit nëpër

gjithë Kosovën. Ky ministër po e bën mrekullinë në stadione, e sidomos në stadione të futbollit. Jam shumë i lumtur që kam hasur në mirëkuptim, sidomos te ministri. Falënderoj edhe partnerin tim më të madh, Ministrinë e Sportit, që po ua jep hakun sportistëve", ka shtuar Ademi.

Kryetari i Prizrenit, Mytaher Haskuka, shpreson se investimet që po bëhen nëpër stadione në Komunën e Prizrenit do të përdoren për avancimin e të rinjve dhe talenteve të reja.

Bottas: Vetëm unë mund ta mposht Hamiltonin

BRUKSEL, 19 GUSHT - Botërori 2019 i Formula 1 është me pushimet verore dhe sezoni do të vijojë më 1 shtator në Belgjikë, në pistën e SPA. Lewis Hamilton, kryesues i botërorit, ka 62 pikë avantazh ndaj shokut të tij të skuadrës së Mercedesit, Valtteri Bottas. Gjithsesi, ky i fundit shprehet se është i vetmi që mund të duelojë me britanikun për titullin kampion bote. "Jemi vetëm në mesin e sezonit dhe gjithçka mund të ndodhë. Të dy pilotojmë të njëjtën makinë. Personalisht jam i përqendruar te puna ime dhe po shoh mundësinë se si ta rikuperoj këtë disavantazh", ka thënë Bottas për "racingnews365". "Ky botëror do të jetë një duel mes meje dhe Hamiltonit deri në fund. Unë jam i vetmi që mund ta ndal atë. Gara e fundit në Hungari nuk ka për t'i prishur aspak planet e



mia", ka shtuar Bottas, që në duke humbur mjaft terren karshi Hamiltonit.

SHKURT

Coutinho: Kam synime të mëdha me Bayernin

Philippe Coutinho është prezantuar si lojtar i ri i Bayern Munchenit. Futbollisti brazilian u është bashkuar gjiganteve gjermanë në formë huazimi, kurse ka bërë me dije se ka synime të mëdha me skuadrën e tij të re. "Për mua ky transferim do të thotë një sfidë e re në karrierë. Vaj në një vend të ri, por në një nga klubet më të mira në Evropë. Unë mezi po pres të luaj këtu. Si Bayerni, edhe unë kam ambicie të mëdha. Jam i bindur që mund t'i arrijmë objektivat e klubit së bashku me shokët e mi të rinj të skuadrës", ka thënë Coutinho. "Trajneri do të vendosë se ku të luaj, por pozicioni im favorit është 10-shi. Besimi që është treguar është shumë e rëndësishme për mua dhe shpresoj të qëndroj këtu për një kohë të gjatë dhe të fitoj shumë tituj", ka deklaruar Coutinho.

Tucheli: Neymari nuk largohet pa e gjetur pasuesin e tij

Trajneri i Paris Saint-Germain, Thomas Tuchel, ka përjashtuar mundësinë e largimit të yllit të skuadrës Neymar. Ai ka thënë se braziliani nuk do të mund të largohet pa e gjetur klubi zëvendësuesin e tij, shkruan "Goal". "Ai nuk do të largohet pa e gjetur pasuesin e tij, nuk është i mundur largimi. Është e qartë, nëse ai do të qëndrojë është lojtar që mund të na ndihmojë që të fitojmë", ka thënë Tuchel.

Monaco në garë për Icardin

Skuadra e Monacos i është shtuar garës për transferimin e Mauro Icardit nga Interi. Sipas medieve në Francë, skuadra e Monacos është gati të ofrojë 65 milionë euro dëmshpërblim plus bonuse, ndërsa Icardi do të përfitojë një rrogë vjetore prej 12 milionë eurosh. Sulmuesi argjentinas preferon kalimin në Juventus, derisa në garë për shërbimet e tij është edhe skuadra e Napolit.

Mandzukiqi, afër Milanit

Kur ka mbetur më pak se një javë nga fillimi i Serisë A, Juventusit i duhet ende t'i largojë disa futbollistë, të cilët zor se mund të gjejnë hapësira në skuadrën e Maurizio Sarrit. Një ndër ta është edhe Mario Mandzukiq. Kroati me shumë gjasa do të largohet në ditët e ardhshme, teksa mediat italiane raportojnë se pas dështimit të kalimit te Bayern Munchenit, në skenë për shërbimet e 33-vjeçarit ka dalë Milani. Palët pritet t'i nisin bisedimet teksa ka të ngjarë që sulmuesi kroat t'ua japë lamtumirën bardhezinjve për t'iu bashkuar Milanit.

Nisin bisedimet për rimeçin Mayweather-Pacquiao

Floyd Mayweather Jr ka treguar se i ka nisur bisedimet me Manny Pacquiao për një rimeç në Arabinë Saudite. Më 2015 Mayweather dhe Pacquiao e zhvilluan meçin më fitimprurës në histori të sporteve luftarake që prodhoi plot 470 milionë funte nga shikueshmëria në TV dhe biletat. Mayweather e fitoi pas një vendimi unanim meçin e cilësuar si "Meçi i shekullit" në MGM Grand të Las Vegasit. Dyshja e ka diskutuar mundësinë për rimeç edhe në të kaluarën, por pa arritur të gjejë marrëveshje deri tani. Në një video të publikuar online, Mayweather thotë: "Dua t'ju falënderohem. Është nder të vij në Arabinë Saudite për t'u ulur dhe për të biseduar me juve për rimeçin Mayweather vs Pacquiao". "Arabia Saudite, Floyd 'Money' Mayweather, po vij", thekson ai. Burimi origjinal i videos mbetet i paqartë.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA -VLADA-GOVERNMENT

MINISTRIA BUIQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT



Sektor i Burimeve Njerëzore
Sektor Ljudskih resursa
Human Resources Sector

Duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të konkursit në sektorin publik shpall:

KONKURS

Titulli i pozitës: Ngasës i Automjetit Transportues për Konfiskim të Masës Drusore
Ref: APK-02/19-LP
Njësia organizative: Agjencia Pyjore e Kosovës
Vendi i punës: Prishtinë (1)
Nëpunësi Mbikëqyrës: Udhëheqësi-ja i/e Sektorit për TI dhe Logjistikë
Grada e pagës (Koefficienti): 7
Lloji i pozitës së punës: Me kohë të pacaktuar,
Kohëzgjatja e periudhës provuese: Gjashtë (6) muaj

Detyrat dhe përgjegjësitë :

- Kujdeset për mirëmbajtjen, servisimin dhe regjistrimin e kamionit dhe automjeteve të tjera të APK-së;
- Bënë ngasjen-voztjen e kamionit me rastin e transportimit të masës drusore të konfiskuar dhe rasteve të tjera të nevojshme për transportim të masës drusore ,apo mallrave të ndryshëm.
- Mirëmban evidencën mbi shpenzimet e karburanteve, serviseve dhe të gjitha shpenzimet tjera të kamionit dhe varësisht prej vlerësimit të Shefit të Sektorit të TI dhe shërbimeve logjistike dhe për automjetet e tjera të APK-së.
- Kryen edhe punë të tjera nga kjo fushë, sipas kërkesave të udhëheqësit të drejtpërdrejt

Shkathësitë kyçe, aftësitë dhe përvoja :

- Së paku dy (2) vite përvojë pune,
- Të jetë i paisur me patentshofer të kategorisë C
- Dëshmi mbi gjendjen shëndetësore- certifikatë mjekësore
- Zotimi i një prej gjuhëve zyrtare në të shkruar dhe në të folur në Republikën e Kosovës,
- Zotësi për punë në mjedis me hierarki të niveleve të ndryshme,
- Aftësi për kryerjen e punëve të kësaj natyre,
- Të mos jetë i gjykuar për vepër penale me vendim të formës së prerë si dhe të mos ketë të iniciuar aktakuzë të plotfuqishme hetimore penale,

Kualifikimet arsimore për këtë pozitë:

Shkolla e mesme

Procedura e Konkurrimit:

Është e hapur për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar.

Data e shpalljes së konkursit: 20.08.2019

Data e mbylljes së konkursit: 03.09.2019

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Vetëm kandidatët që hyjnë në listën e përzgjedhur do të informohen.

Dokumentet duhet të jenë fotokopje përndryshe nuk kthehen.

Procedura e Aplikimit: Formularët për aplikim mund të merren dhe dorëzohen në Sektorin e Burimeve Njerëzore ,zyra nr.2 në Agjencinë Pyjore të Kosovës, Rr. Zenel Salihu 1/A Prishtinë (prapa Muzeut të Kosovës).

Për informacione tjera shtesë kontaktoni në telefonin nr. 038-200-38-482 çdo ditë pune prej orës 8.⁰⁰ deri 16.⁰⁰.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA -VLADA-GOVERNMENT

MINISTRIA BUIQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT



Sektor Ljudskih resursa
Human Resources Sector

Na osnovu člana 8 Zakona o Radu Br.03/L-212 i Administrativno uputstvo (MRSS) br. 07/2017 o regulisanju procedura javnog konkursa, objavljuje:

KONKURS

Naziv pozicije: Vozač transportnog vozila za oduzimanje drvine mase
Ref: AŠK -02/19-LP
Organizaciona Jedinica: Agjencia za Šume Kosova
Radno mesto: Priština
Nadzorni Sluzbenik: Rukovodilac Sektora za IT i logistiku
Nivo plate (Koefficient): 7
Vrsta radne pozicije: Na neodređeno vreme
Probni Vremenski period: šest (6) meseci

Zadaci i odgovornosti:

- Vodite računa o održavanju, servisiranju i registraciji kamiona KFA i drugih vozila;
- Vozi i vozi kamion prilikom prevoza oduzete drvine građe i drugih slučajeva neophodnih za prevoz drveta ili razne robe.
- Vodi evidenciju o gorivu, servisiranju i svim ostalim troškovima kamiona i zavisi od procene šefa sektora IT i logističkih usluga i za ostala vozila KFA.
- Obavlja druge dužnosti u ovoj oblasti prema zahtevu direktnog vodje

Ključne veštine, sposobnosti i iskustvo :

- Najmanje dve (2) godine radnog iskustva,
- Opremite se vozačkom dozvolom kategorije C
- Dokaz o zdravlju - lekarsko uverenje
- poznavanje jednog od zvaničnih jezika u pisanom i govornom obliku u Republici Kosovo,
- sposobnost rada u okruženjima sa hijerarhijama različitih nivoa,
- posobnosti za izvršavanje takvih zadataka,
- da nije pravosnažno osuđen za krivično delo i da ne bude pokrenuta potpuna optužnica za krivično istragu,

Obrazovna i stručna kvalifikacija za ovu poziciju:

-srednja škola

Procedura Konkursanja:

Je otvorena za sve državljanima Republike Kosova za punoletne koji imaju potpuno sposobnost za delovanje.

Datum ponavljanja konkursa: 20.08.2019

Datum zaključenja konkursa: 03.09.2019

Nekompletirane dokumentacije se neće uzeti u obzir.

Biće informisani samo kandidati koji uđu u užu spisak kandidata.

Dokumenti treba biti fotokopije jer se neće vratiti.

Postupak Aplikiranja: Formulari za apliciranje mogu se uzeti i predaju nakon popunjenja u Sektoru Ljudskih Resursa, kancelarija br.2 u Agenciji za Šume Kosova, Ul. Zenel Salihu 1/A Prishtina (iza Muzeja Kosova).

Za druge dopunske informacije kontaktirajte na telefonu br. 038-200-38-482 svaki radni dan, od 8.00 do 16.00 časova.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA -VLADA-GOVERNMENT

MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Agjencia Pyjore e Kosovës
Agjencia za Šume Kosova
Kosovo Forest Agency

Sektori i Burimeve Njerëzore
Kancelarija osoblja i razvoja ljudskih resursa
Office of Personnel and Human Resources Development

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës NR.03/L-149 dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Miratimeve përmes SIMBNJ të pozitave nga DASHC-MAP me datë 16.08.2019, bënë:

SHPALJEN E KONKURSIT PËR KËTO VENDE PUNE

-I-

Titulli i pozitës: Zyrtar/e për Administrimin e Teknologjisë Informativë
Ref: APK-12/19
Njësia organizative: Agjencia Pyjore e Kosovës (APK)
Vendi i punës: Prishtinë (1)
Nëpunësi Mbikëqyrës: Udhëheqësi i Sektorit për TI dhe Logjistikë- DFSHP
Kategoria funksionale: Nivel i profesional
Grada e pagës (Koefficienti): Grada 9 koefficienti 7
Lloji i pozitës së punës: E KARRIERËS (E përhershme),
Kohëzgjatja e periudhës provuese: Dymbëdhjetë (12) muaj

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgatitja e kërkesave të shfrytëzuesve dhe specifikacioneve tjera teknike;
- Kujdeset për montimin e pajisjeve të teknologjisë informativë përfshirë kompjuter, printer, skaner dhe pajisje tjera;
- Ndihmon personelin e institucionit në përdorimin e pajisjeve të teknologjisë informativë, aplikacioneve dhe bazave të dhënave dhe kryen aktivitete tjera me qëllim për t'u ofruar gjithë personelit qasje të lehtë në sistemin e teknologjisë informativë;
- Instalon kompjuterët me sisteme operative Windows, Office dhe softuer tjetër sipas nevojës duke u kujdesur për ruajtjen e shënimeve;
- Ndihmën në rregullimin dhe monitorimin e masave përforcuese të programeve softuerike dhe shërbimet ndihmëse Helpdesk.
- Është përgjegjës për sallën e internetit, kompjuterit dhe tërë inventarit i cili gjendet në sallë;
- Mirëmban pajisjet elektronike për regjistrim mbi ardhjen dhe vajtjen e punëtorëve nga puna;
- Mirëmban dhe bënë futjen e të dhënave në webfaqe;

Shkathësitë kyçe, aftësitë dhe përvoja :

- Të ketë njohuri profesionale në fushën e Teknologjisë Informativë;
- Shkathësi për të organizuar punën e vet dhe për të koordinuar stafin e nivelit administrativ;
- Shkathësi hulumtues, analitik dhe vlerësues të informacionit, aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit)
- Zotimi i një prej gjuhëve zyrtare në të shkruar dhe në të folur në Republikën e Kosovës;
- Të mos jetë i gjykuar për veprë penale me vendim të formës së prerë si dhe të mos ketë të iniciuar aktakuzë të plotfuqishme hetimore penale,

Nëse kandidati ka punuar apo punon në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës:

- Të ketë vlerësime pozitive të punës në dy (2) vitet e fundit nga Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë
- Të mos jetë në procedurë disiplinore dhe të mos jetë i ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore në tri (3) vitet e fundit.

Kualifikimet arsimore dhe profesionale për këtë pozitë:

- Diplomë Universitare Fakulteti i Inxhenerisë Elektrike dhe Kompjuterike, Shkencat Kompjuterike, pa përvojë pune ose shkollë e lartë 2 vite përvojë pune;

-II-

Titulli i pozitës: Zyrtar/e për Pylltari 2
Ref: APK-13/19
Njësia organizative: Drejtorati Koordinuese Regional i APK-së në Prishtinë
Vendi i punës: Prishtinë (1)
Nëpunësi Mbikëqyrës: Drejtori i Drejtoratit Koordinuese Regional në Prishtinë
Kategoria funksionale: Profesional
Grada e pagës (Koefficienti): Grada 9, Koefficienti 7
Lloji i pozitës së punës: E KARRIERËS (e përhershme)
Kohëzgjatja e periudhës provuese: dymbëdhjetë (12) muaj

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Do të menaxhoj, të organizoj dhe kryej punët profesionale në damkim në të dy sektorët, projektim, grumbullim, llogaritje dhe hartim të planeve të ndryshme, vjetore dhe operative në kuadër të drejtorisë koordinuese
- Propozon, harton dhe monitoron punët në pyllëzimet në nivel të drejtorisë koordinuese
- Organizon punët me përgjegjës të njësisë komunale, teknik për silvikulturën e pyjeve, dhënie të këshillave të pronarëve të pyjeve private, për trajtimin e pyjeve private, merr pjesë në damkim në pyje private
- Do të marrë pjesë në mbikëqyrjen dhe monitorimin e operatorëve ekonomik që operojnë me pyje dhe toka pyjore, përcjellja gjatë punimeve të tyre, dhe kontrolli strikt të punimeve të operatorëve ekonomik në punët silvikulturore.
- Mban kontakte pune dhe konsulta dhe sipas nevojës ndihmon sektorët përkatës në nivel të APK në Qendër
- Harton raporte javore, mujore, vjetore në sferën e silvikulturës pyjore
- Propozon sipërfaqet për pyllëzim, harton programet e pyllëzimeve si dhe merr pjesë aktive në organizimin e pyllëzimeve dhe mbikëqyrjen e pyllëzimeve në komuna përkatëse dhe në nivel të
- Drejtorisë Koordinuese, si dhe merr pjesë në komisionet e ndryshme në interes të DKR të APK si dhe ato në procesin e pranimit të fidanëve dhe përcjell gjendjen e tyre shëndetësore si dhe propozon masat silvikulturore për fidanët në fjalë.
- Dhënie e udhëzimeve dhe shpjegimeve teknike- rojeve të pyllit për dokumentacionin përcjellës, udhëzimi i pronarëve privat lidhur me procedurat e lejimit të prerjes në pronat e

tyre, do të vizitohet pyjet private dhe kontrolloj damkosjet në aspektin kualitativ dhe sasior Grumbullon të dhëna nga terreni silvikulturë, propozon planin për pyllëzim, prerje, rrallime, pastrime, rrallime para tregtare, hapje të rrugëve të reja nëpër ngastra ku do të kryhen punimet;

- Realizon dhe kryen punëve të tjera sipas urdhrimit të Udhëheqësit të Sektorit për Menaxhim me Pyje në kuadër të DKR - APK së përkatësisht Drejtorit të DKR-APK

Shkathësitë kyçe, aftësitë dhe përvoja :

- Së paku 2 vite përvojë pune në profesion
- Aftësi për vendimmarrje, planifikim, vendosjen e prioriteteve në punë dhe vetë iniciativë
- Njohja e kompjuterit dhe aftësia për të përdorur me efekt Microsoft Office, pajisjet tjera;
- Zotimi i një prej gjuhëve zyrtare në të shkruar dhe në të folur në Republikën e Kosovës
- Aftësia dhe gatishmëria për bashkëpunim dhe punë në terren.
- Aftësi për përdorim të GPS dhe mjeteve tjera të terrenit.
- Të mos jetë i gjykuar për veprë penale me vendim të formës së prerë si dhe të mos ketë të iniciuar aktakuzë të plotfuqishme hetimore penale,

Nëse kandidati ka punuar apo punon në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës:

- Të ketë vlerësime pozitive të punës në dy (2) vitet e fundit nga Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë
- Të mos jetë në procedurë disiplinore dhe të mos jetë i ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore në tri (3) vitet e fundit.

Kualifikimet arsimore dhe profesionale për këtë pozitë:

- Diplomë Universitare -Fakulteti i Pylltarisë

III.

Titulli i pozitës: Zyrtar/e për Buxhet dhe Financa 2
Ref: APK-14/19
Njësia organizative: Drejtorati Koordinuese Regional i APK-së në Prishtinë
Vendi i punës: Prishtinë (1)
Nëpunësi Mbikëqyrës: Drejtori i Drejtoratit Koordinuese Regional në Prishtinë
Kategoria funksionale: Profesional
Grada e pagës (Koefficienti): Grada 9, Koefficienti 7
Lloji i pozitës së punës: E KARRIERËS (e Përhershme),
Kohëzgjatja e periudhës provuese: Dymbëdhjetë (12) muaj

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Do të përcjell dhe menaxhoj çështjet kontratave me operatorët ekonomik-guroret dhe kontraktuesit tjerë në tokat pyjore të dhëna me qira(pagesat) e tyre në DKR të APK
- Do të pranoj, ruaj, shpërndaj dhe arkivoj material Zyrtar: blloqe të pagesave, fletë përcjellje për pyje publike dhe private, blloqe të konfiskimit, leje për prerje në pyjet private etj, si dhe dokumentacion tjetër zyrtar nga APK qendër dhe AP komunale
- Në bazë të kërkesës së Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të APK do të beje hartimin e kërkesave buxhetore me rastin e hartimit të Propozim Buxhetit, Kornizës afatmesme të shpenzimeve dhe rishikimit të buxhetit, auditimit të brendshëm dhe të jashtëm në nivel të Drejtorisë koordinuese. Të përgatis raporte dhe informata në kohë të caktuar dhe cilësi sipas kërkesave të kësaj Drejtorie.
- Përcjelljen realizimin dhe pagesat e Ç' do kontrate që ka të bëjë me DK e APK dhe operator të tjerë të kontraktuar nga APK Qendër apo DK e APK
- Bene ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve dhe regjistrimin e faktuarve të pagesës në nivel DK të APK dhe i procedon për pagës në APK qendër etj
- Përcjell dhe raportin në APK qendër lidhur me të hyrat në kuadër të AP Komunale dhe në DK të APK, si dhe mban kontakte me Drejtorinë përkatëse në APK -qendër lidhur me çështjet ekonomiko -financiare dhe sipas nevojës ndihmon të njëjtin
- Hartimin e raporteve financiare javore, mujore, periodike dhe vjetore në nivel të DKR dhe raportimi i tyre për nevoja të APK -qendër dhe të DK të APK
- Monitoron pranimin e parasë së imtë (Petty cash), shpenzimin si dhe përcjell shpenzimet të ti për nevoja të DKR të APK
- Kryen edhe punë dhe detyra tjera sipas urdhrimit të Udhëheqësit të DKR të APK

Shkathësitë kyçe, aftësitë dhe përvoja :

- Së paku 2 vite përvojë pune në profesion
- Njohuri dhe përvojë në fushën e buxhetit dhe financave
- Shkathësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathësi hulumtues, analitik, vlerësues dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave
- Njohja e kompjuterit dhe aftësia për të përdorur me efekt Microsoft Word, excel, power point internet;
- Zotimi i një prej gjuhëve zyrtare në të shkruar dhe në të folur në Republikën e Kosovës
- Aftësia dhe gatishmëria për punë nën presion.
- Aftësi për përgatitje të raporteve, shkresave, kërkesave dhe informatave zyrtare.
- Të mos jetë i gjykuar për veprë penale me vendim të formës së prerë si dhe të mos ketë të iniciuar aktakuzë të plotfuqishme hetimore penale,

Nëse kandidati-ja ka punuar apo punon në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës:

- Të ketë vlerësime pozitive të punës në dy (2) vitet e fundit nga Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë
- Të mos jetë në procedurë disiplinore dhe të mos jetë i ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore në tri (3) vitet e fundit.

Kualifikimet arsimore dhe profesionale për këtë pozitë:

- Dipomë Universitare -Fakulteti Ekonomik

Procedura e Konkurrimit:

Është e hapur edhe për kandidatë jashtë Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës.

Data e shpalljes së konkursit: 20.08.2019

Data e mbylljes së konkursit: 03.09.2019

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit NR.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Vetëm kandidatët që hyjnë në listën e përzgjedhur do të informohen.

Dokumentet duhet të jenë fotokopje përndryshe nuk kthehen.

Procedura e Aplikimit: Formularët për aplikim mund të merren dhe dorëzohen në Sektorin e Burimeve Njerëzore, zyra nr.2 në Agjencinë Pyjore të Kosovës, Rr. Zenel Salihu 1/A Prishtinë (prapa Muzeut të Kosovës).

Për informacione tjera shtesë kontaktoni në telefonin nr. 038-200-38-482 çdo ditë pune prej orës 8.00 deri 16.00.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA -VLADA-GOVERNMENT

MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Agjencia Pyjore e Kosovës
Agjencia za Šume Kosova
Kosovo Forest Agency

Sektor i Burimeve Njerëzore
Sektor Ljudskih Resursa
Office of Personnel and Human Resources Development

Na osnovu Zakona za Civilnu Službu Republike Kosova Br.03/L-149, Pravilnika Br.02/2010 za Procedure Rekrutovanja u Civilnoj Službi Republike Kosova i Usvajanja izdato preko ISMJALJR,sa pozicija od MJA, dana 16.08.2019, Raspisuje:

KONKURS ZA SLEDEĆA RADNA MESTA

-I-	
Naziv pozicije:	Službenik za administraciju informacionih tehnologija
Ref:	AŠK -12/19
Organizaciona Jedinica:	Agencia za Šume Kosova AŠK u Priština
Radno mesto:	Priština (1)
Nadzorni Službenik:	Šef sektora za informatiku i logistiku - DFSHP AŠK u Prištini
Funkcionalna kategorija:	Profesionalni nivo
Grada plate (Koeficient):	Grada 9, koeficient 7
Vrsta radne pozicije	KARIJERNE (stalno)
Probni Vremenski period:	12 meseci

Zadaci i odgovornosti:

- Priprema korisničkih zahteva i drugih tehničkih specifikacija;
- Vodite računa o ugradnji opreme informacione tehnologije, uključujući računare, štampače, skener i drugu opremu;
- Pomaže osoblju institucije u korištenju opreme, aplikacija i baza podataka u informacionoj tehnologiji i obavljanju drugih aktivnosti kako bi se svim zaposlenima omogućio lak pristup sistemu informacionih tehnologija;
- instalira računare sa Vindovs, Office operativnim sistemima i drugim softverom po potrebi, vodeći računa o čuvanju podataka;
- Pomažu u regulisanju i nadgledanju mera za jačanje softvera i službi podrške.
- Odgovorna je za internet sobu, računar i sav inventar koji se nalazi u sobi;
- Održava elektronsku opremu za snimanje za dolazak i odlazak radnika sa posla;
- Održava i bilježi podatke na veb stranicama

Ključne veštine, sposobnosti i iskustvo :

- Da poseduju stručno znanje iz oblasti informacionih tehnologija;
- Sposobnost da organizuju svoj rad i koordinišu administrativno osoblje;
- veštine istraživanja, analitike i evaluacije, sposobnost izvršavanja zadataka i zadataka pod pritiskom;
- Veštine softverskog aplikacionog softvera (Vord, Ekcel, Pover Point, Pristup, Internet)
- poznavanje jednog od zvaničnih jezika u pisanom i govornom obliku u Republici Kosovo;
- Da nije pravosnažno osuđena za krivično delo i da neće biti pokrenuta potpuna krivična istražna optužnica.

Ako su kandidati radili ili rade u Civilnoj Službi Republike Kosova:

- Dve (2) zadnje godine da ima pozitivne ocene od svog neposrednog rukovodioca,
- Da nije u disciplinskoj proceduri i da nije kažnjen sa disciplinskim merama u tri (3) zadnje godine.

Obrazovna i stručna kvalifikacija za ovu poziciju:

- Univerzitetska diploma - Fakultet elektrotehnike i računarske tehnike, računarske nauke, nema radnog iskustva ili srednja škola 2 godine radnog iskustva;

-II-	
Naziv pozicije:	Službenik za šumarstvo 2
Ref:	AŠK -13/19
